UNIQA > Njoftime per shtyp > Njoftim për shtyp 05.12.2017

## Njoftim për shtyp 05.12.2017

### Sigurimi nga katastrofat, përmbytjet, tërmetet etj.

Vit pas viti, Shqipëria vazhdon të mbetet pullë e kuqe në hartën e ekspozimit nga nga katastrofat natyrore, duke u renditur si një nga vendet më të rrezikuara. Edhe raporti i fundit i "Global Risks", tregoi se Shqipëria ka indeksin më të lartë, jo vetëm në rajon por edhe në Europë, për ekspozimin ndaj katastrofave natyrore si përmbytjet, tërmetet, rrëshqitjet e dherave etj. Rrezikshmëria matet edhe nga mundësia që ka vendi për t'i përballuar katastrofat natyrore që mund ta godasin. Dhe pikërisht kur vjen fjala tek mundësitë aty ne përsëri mbetemi me të "kuqe", sepse vendi ynë nuk ka as kapacitete e as strategji për të parandaluar të tilla fatkeqësi.

Dhe në ditë si këto që po përjetojmë, nuk na nevojitet më as raporti i Global Risks sepse rrezikun e pamë me sytë tanë, e panë dhe e përjetuan me qindra familje shqiptare, që u zunë ngat ca nga zemërimi i natyrës dhe ca nga dëmi që vetë njeriu i ka bërë natyrës ndër vite.

Banorët e Fierit, Durrësit, Vlorës, Kamzës, Laçit etj, panë se si gjithçka kishin ndërtuar me mund e sakrificë për vite me radhë iu mbulua nga uji e balta në vetëm pak minuta apo brenda pak orëve.

Askush në botë, nuk mundet dot të parandalojë as përmbytjet, as tërmetin dhe as ngjarjet e tjera të paprashikuara. Por ndryshe nga ne, ajo që ndodh nëpër botë është se pas çdo ngjarje sado shkatërruese të jetë ajo, efekti postngjarje është më i vogël, dhimbjet janë më të pakta, sepse kostot financiare rimëkëmben dhe familjet kanë mundësi ta rindërtojnë sërish jetën si më parë.

Ne të gjithë jemi dëshmitarë të ngjarjeve të këtyre ditëve por edhe dhe të atyre viteve të fundit. Shirat e furishëm të këtyre ditëve po lënë pas dëme kolosale financiare. Fatmirësisht shpëtuan jetët e qindra qytetarëve, por jeta e tyre është e vështirë të rinisë pas shkatërrimit total të shtëpisë së tyre, makinës, bagëtive, dyqanit, magazinës apo çdo gjëje tjetër me vlerë që ata kishin.

I njëjti skenar fatkeq përsëritet disa herë në vit, dhe prej shumë vitesh në mënyrë konstante. Një herë Veriu i Shqipërisë, një herë Jugu e një herë Qendra, nuk ka rëndësi vendndodhja gjeografike, rëndësi ka që ngjarje të tilla prekin me mijëra familje shqiptare, të cilat "nuk do ta ngrenë më kokën" ndoshta për gjithë jetën.

Mbi 200 mijë persona janë prekur vetëm nga përmbytjet e dy viteve të fundit, ndërsa dëmet përllogariten në miliona euro. Nga ana tjetër duhet të kemi parasysh që këto shifra janë vetëm ato që janë raportuar për publikun, që do të thotë në realitet këto shifra mund të jenë shumë herë më të larta. Ndërsa dëmet e këtyrë ditëve është ende herët për t'i konkluduar. Për banorët e prekur gjithçka është dërrmuese, për të tjerët shifrat janë tronditëse.

Katastrofat nuk përzgjedhin, ato thjeshtë ndodhin dhe marrin përpara ç'të gjejnë.

Sa herë ndodhin përmbytje, sa herë vendi kaplohet nga zjarret (siç ndodhi verën e kaluar), sa herë bie një tërmet rikthehemi tek ngjarjet, organizojmë tavolina të rrumbullakta dhe flasim për planin e së ardhmes, vlerësimin e situatës etj.

Por shumë shpejt del dielli, ujrat tërhiqen, magnituda e tërmetit bie dhe të dëmtuarin vazhdojnë të enden dyerëve të bashkisë apo qeverisë për të marrë dëmshpërblimin, në mënyrë që më së paku të mbijetojnë!

Kalojnë disa ditë dhe ngjarja harrohet. Askush nuk flet më për përmbytjet derisa natyra të bëjë gjëmën e radhës, tërmeti harrohet me shpresën se nuk do të bjerë sërish dhe askush nuk flet më për përpilim planesh e strategjish dhe as për vënien e tyre në funksion të parandalimit të këtyre ngjarjeve. Duket sikur dielli i përkohshëm i bën të harrojnë gjëmat e furtunave të mëdha.

Dhe ja, vjeshta iku dhe ujrat e furishëm të saj përmbytën qindra shtëpi, mijëra bagëti dhe dhjetëra biznese. Erdhi dimri dhe shirat do të rikthehen, ose ngricat dhe rrëshqitjet e dherave do të vijnë natyrshëm bashkë me të.

Së bashku me ta do të rikthehet edhe pasiguria, do të rikthehet edhe paniku dhe dëmet tek qytetarët, për pasojë do të shtohen edhe "hallet" e shtetit se si do ti kapërcejnë situata të tilla. Sërish do të ketë dëme miliona euroshe dhe sërish do të jenë qytetarët ato që do ti paguajnë, sepse Fondet e Emergjencave Civile krijohen nga taksat e qytetarëve. Ato taksa që secili prej nesh paguan për t'u shtruar rrugë, për t'u rikonstruktuar shkolla, çerdhe e spitale, për të përmirësuar rrjetin e energjisë dhe ujësjellësit etj, do të duhet që një pjesë e konsiderueshme e tyre të shkojë për atë target grup qytetarësh që preken nga të tilla fatkeqësi natyrore, ndërsa të tjerë do të mbeten fare pa gjë, sepse fondet aq janë!

Ka një fakt që anashkalohet qëllimisht në historinë e katastrofave natyrore në Shqipëri. Ato janë cilësuar gjithmonë si "katastrofa", ndërkohë që nëse do të ishin siguruar do të quheshin si "ngjarje sigurimi". Ajo që unë cilësoj si "ngjarje sigurimi" dhe jo "katastrofë natyrore" janë pasojat ekonomike të këtyre ndodhive, sepse efekteve humane nuk mundet dot t'u shmangemi. Ne nuk jemi Zoti që të shmangim shiun, breshërin, tërmetin e temperaturat e larta. Por ne mundet të parandalojmë dëmet financiare që rrjedhin prej tyre. Këtë Po, mundet ta bëjmë nëse ka vullnet e nëse të gjithë biem dakord.

Por, kush mund të sigurohej në ngjarje të tilla dhe si do të mbulohej ky sigurim?

Shqipëria nuk bën shpikje! Praktika botërore na referon shembuj, ku këto lloj rreziqesh janë të detyruara me ligj që të sigurohen dhe mjafton që këto praktika pune të implementohen edhe tek ne.

Format e realizimit mund të jenë të ndryshme. **Një nga mënyrat efikase** do të ishte që shteti ta marrë vetë përsipër që ti mbulojë këto katastrofa, duke blerë rreziqet nga kompanitë e sigurimeve në Shqipëri. Këto të fundit janë të risiguruara dhe bashkëpunojnë me disa nga kompanitë më me emër në botë, kompani të mëdha siç është Munich Re, Sëiss Re apo Hannover Re, të cilat ofrojnë mundësitë për të mbuluar katastrofat natyrore të të gjitha përmasave në vend.

**Mënyra tjetër** është që shteti të ndërtojë një ligj, ashtu siç ka ndodhur në Turqi, në Greqi, në Rumani, në Poloni dhe pothuaj në të gjithë Europën ku sigurimi i banesave është i detyrueshëm.

Përllogaritja e primit të sigurimit bëhet duke llogaritur rreziqet potenciale të një vendi në një vit. Më konkretisht, në Shqipëri konsiderohen rreth 1 milionë banesa dhe biznese, primi i të cilave shkon përreth 30 milionë euro, të cilat shkojnë për blerjen e rreziqeve, pasi duhet të krijohet një shtresë prej minimalisht

300 milionë eurosh në vit. Atëherë llogaritet sa sa duhet të jetë çmimi i këtij mbulimi dhe mbi këtë bazë caktohet edhe primi i sigurimit, i cili varion nga 10 deri në 70 euro për familje. Ky prim paguhet një herë në vit dhe mbulon të gjitha rreziqet nga katastrofat natyrore.

Duke realizuar këtë këtë lloj sigurimi dhe duke pasur një rezervë minimale, shteti mund të ndërhyjë vetëm për shtresat që janë në nevojë, që mund të jetë një vlerë 2-3 milionë euro, ndërsa pjesa tjetër le të paguhet nga qytetarët, nga bizneset, nga ato që i kanë mundësitë për t'i paguar, duke krijuar kështu një garanci për dëmet që mund t'u shkaktohen. Në këtë mënyrë qytetarët do të kenë një marrëdhënie me industrinë private të sigurimeve dhe shteti duhet të luajë rolin e një arbitri shumë të fortë dhe detyrues për tregun e sigurimeve, në mënyrë që siguruesit tu përgjigjen menjëherë qytetarëve në rast dëmesh.

Ekziston çdo gjë e nevojshme për qytetarët, por nuk ekziston dëshira e atyre që duhet të sigurohen. Nga ana tjetër dhe mungon ligji në Shqipëri, një ligj i cili do të ndërtonte një mbrojtje kolektive të gjithanshme për të gjithë vendin.

Realizimi i njërës prej platformave të sipërpërmendura, do të shmangte përfundimisht përgjegjësinë e shtetit ndaj qytetarëve, do ti jepte një frymëmarrje Buxhetit të Shtetit, ekonomia e vendit do të rigjenerohej dhe mbi të gjitha krijohet pavarësia e çdo familjeje nga shteti! Në fund të fundit çdo familje do ta rindërtonte jetën nga e para, pavarësisht fatkeqësisë që i ndodh.

Duhet të kthehemi tek përgjegjësia individuale, që secili të ndjejë përgjegjësi për atë që ka dhe të heqë dorë nga kërkesa duke iu drejtuar shtetit, sepse ky është një mentalitet i vjetër i ngulitur keq, dhe njerëzit vazhdojnë që për çdo problem që kanë ti drejtohen shtetit, bashkive, apo institucioneve shtetërore, kur në fakt duhet ti drejtohen vetes dhe tregut të sigurimeve, sepse ai është shpëtimtari financiar, ashtu siç ndodh edhe në të gjithë botën.

Shqipëria është një zonë e minuar e katastrofave natyrore. Që të minimizohen shanset e shpërthimit të kësaj mine, duhet që shteti të ndërhyjë për të parandaluar dhe zgjidhur sfidat që koha e vendi na i imponon.

Shumë vetë i quajnë sigurimet si taksë dhe jo si shërbim të domosdoshëm. Dhe paratë për to mendojnë se duhet të ketë kanale shtetërore t'i marrin. Jo. Sa më shumë sigurime të kesh aq më i pavarur je nga shteti, nga bashkia, nga shëndetësia etj. Ne paguajmë vetëm 30 euro për frymë për sigurimet në vit, ndërsa bota paguan mbi 3000 euro për frymë në vit. Ky është ndryshimi. Nëse paguajmë të gjithë nga pak, atëherë do të kemi një çmim sigurimi më të ulët. Nëse ka pak vetë që bëjnë sigurimin nga përmbytja apo tërmeti, atëherë primi i sigurimit është më i lartë.

Në Shqipëri paguhen në vit rreth 20 mijë automjete të përfshira në aksidente dhe mbeten pa paguar po 20 mijë që janë shkaktare. Në gjithë botën paguhen të dyja palët sepse kanë prim sigurimi më të lartë dhe të gjitha mjetet kanë sigurim për përplasjen me mjet tjetër.

Pra le ti kthejmë sytë nga sigurimet e mos t'i knosiderojmë ato si taksa, por shërbim si gjithë shërbimet e tjera. Sigurimet janë shumë të lira për rrezikun që mbartin. Referojuni atyre dhe do të jeni përfituesë.

UNIQA > Njoftime per shtyp > 16.11.2017

## 16.11.2017

### Ajka e artistëve shqiptarë në zemër të Vjenës

“Vienna salutes to Tirana” është koncerti që do të zhvillohet me zërat e mrekullueshëm të artistëve shqiptarë dhe asutriakë, me rastin e 105-Vjetorit të Shtetit Shqiptar.

Me mbështetjen e patjetërsueshme të SIGAL UNIQA Group Austria, sopranoja me famë botërore Inva Mula, balerini i shkëlyer Eno Peçi, violinisti Olen Çezari, baritoni Gëzim Myshketa dhe pianisti Genc Tukiçi janë disa nga artistët shqiptarë me famë botërore që do të ngjiten në skenën e “Konzerthaus Wien”, në sallën Mozart, sonte në orën 19:30, për të përcjellë emocione të jashtëzakonshme për të gjithë të pranishmit.

Ajka e artistëve shqiptarë, të shoqëruar nga Volkhard Steude, Kuarteti i Filarmonisë Vjeneze dhe Maria Yakovleva, primabalerina e Operës Shtetërore të Vjenës, do të performojnë pjesë nga autorët më të mirë të muzikës botërore dhe shqiptare.

Ky koncert bëhet i mundur nga kompania shqiptaro-austriake SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe mbahet në kuadër të përvjetorit të 105-të të themelimit të Shtetit Shqiptar.

Rreth 9 vjet më parë, sopranoja me famë botërore Inva Mula, solli emocione të jashtëzakonshme në Mbrëmjen Gala të 10-Vjetorit të SIGAL UNIQA në Teatrin e Operas dhe Baletit në Tiranë dhe vetëm tre vjet më parë, në 2014, sërish SIGAL UNIQA ngjiti në skenë balerinin e rrallë shqiptar Eno Peçi për të performuar për publikun vendas.

Promovimi i artit, kulturës, sportit, artistëve dhe sportistëve shqiptarë dhe promovimi i Shqipërisë në arenat ndërkombëtare është një mision i kompanisë më të madhe të sigurimeve në Shqipëri, SIGAL UNIQA, e cila përveç të të bërit biznes në industrinë e sigurimeve, ka kontribuar vazhdimisht që prej themelimit të saj më 1999 në promovimin dhe zhvillimin e vlerave të Shqipërisë dhe Shqiptarëve.


SIGAL


SIGAL

**Kompania shqiptare që renditet në TOP 100 e Europës Jug-Lindore**

Ofruesi më i madh i të dhënave financiare për Europën Jug-Lindore, SeeNews.com publikoi të dhënat për 100 kompanitë më të mëdha të sigurimeve, të bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

Sipas të dhënave nga SeeNews, në renditjen e 100 kompanive më të mëdha të sigurimeve për Europën Jug-Lindore, Shqipëria përfaqësohet me tri kompani sigurimesh, ku bie në sy renditja në vendin e 54 nga 100 e kompanisë SIGAL UNIQA Group Austria.

Kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri, SIGAL UNIQA Group Austria, rezulton të jetë edhe më e madhja në rajon.

Kjo nuk është hera e parë që kjo kompani shqiptare renditet ndër më të mëdhatë dhe me shërbimin më të mirë ndaj klientëve ndërmjet qindra kompanive të tjera të Europës.

SIGAL UNIQA është një grup i rëndësishëm financiar, i përbërë nga 8 kompania Jetë dhe Jo-Jetë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, numëron mbi 1200 punonjës dhe agjentë dhe mbi 500 mijë klientë.

SIGAL UNIQA udhëheq me rreth 30% tregun shqiptar të sigurimeve.

UNIQA > Njoftime per shtyp > SIGAL UNIQA në TOP 50 kompanitë më të mëdha

## SIGAL UNIQA në TOP 50 kompanitë më të mëdha

Në një rankim që i bën revista “Monitor” 200 sipërmarrjeve më të mëdha në Shqipëri, SIGAL UNIQA Group Austria renditet në vendin e 44 për vitin 2016.

Rankimi është bërë në bazë të të ardhurave vjetore, ku SIGAL UNIQA rezulton me 7 vende rritje në krahasim me 2015-ën.

SIGAL UNIQA kryeson tregun e sigurimeve që prej 2002 falë besimit të qindra-mijëra klientëve në Shqipëri dhe rajon.

*Intervista e plotë e z. Ponari dhënë për revistën "Monitor"*

**Z. Avni PONARI,**

**CEO-SIGAL UNIQA Group Austria, Shqipëri-Kosovë-Maqedoni**

1. **Si do e vlerësoni ecurinë e kompanisë Sigal për vitin 2016 dhe periudhën e deritanishme të 2017-s?**

Të flasësh për vete është e vështirë, por nga ana tjetër opinioni publik kërkon të dijë gjithmonë diçka për ecurinë e një kompanie shërbimesh, në të cilën është në fund të fundit një investitor i vogël.

Sigal, de facto është prezent në tre shtete, Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, por nga ana tjetër de jure është prezent në 23 shtete të Europës. E them këtë sepse kompania është prezente çdo tre muaj në mbledhjet e bordeve të zgjeruara të të gjitha këtyre vendeve të Europës. E kjo nuk është pak.

Ne jemi pikë së një kompani europiane që aplikojmë standarte dhe produkte europiane.

Të jesh pjesë e një kompanie europiane do të thotë se ne i kemi bërë “detyrat e shtëpisë”, pra ne jemi pjesë e Unionit Europian.

Këtë duhet ta bëjnë të gjithë. Ne punojmë me standarte europiane por fatkeqësisht jetojmë me standartet shqiptare.

Jetojmë në një treg ku gjërat nuk janë të barabartë e madje janë të vështira për shkak të konkurrencës inatçore dhe jo të produktit, për shkak të konkurrencës së çmimit dhe jo të shërbimit, për shkak të konkurrencës së mentalitetit dhe jo të vlerësimit të klientit. Por ne po jetojmë në këtë ambient dhe natyrisht jemi përshtatur. Përpiqemi të tërheqim të tjerët drejt së mirës, drejt

konkurrencës së ndershme dhe elementëve pozitivë të tregut, por forca tërheqësee pjesës që nuk e do tregun, është disa herë më e fortë dhe ndonjëherë na tërheq edhe ne.

Prandaj tregjet e sigurimeve mbikëqyren dhe mbikëqyrja ka standarte, por duhet vetëm të respektohen stadartet.

E kush më mirë se dixhitalizimi mund ti realizojë këto standarte.
Ndërto një program dhe ruaj transparencën e tregut, ky është roli i mbikëqyrësit në Shqipëri, me një treg as 30 euro për frymë, një treg ku bankat nuk kanë asnjë konkurrent investimi dhe bëjnë siç duan me klientët. Kjo sepse mungon tregu financiar jo bankar që janë sigurimet, letrat me vlerë, fondet e pensioneve etj, etj.

Nëse do ti kthehemi 2016-ës, do ta cilësoja një vit pozitiv dhe të suksesshëm për SIGAL UNIQA,pavarësisht sfidave që na dikton koha, vendi, tregu ku operojmë, aktualiteti politiko-social etj.

Të qenurit liderë të tregut që prej vitit 2002, na vendos ne në një pozicion sa komod aq edhe me përgjegjësi të larta, përgjegjësi për tu shërbyer klientëve gjithmonë e më mirë, për të gjetur kanalet e duhura të zgjidhjes së pengesave që dalin e për të menaxhuar dhe mbajtur më së miri pozicionin që kemi.

2. **Cila është pika më e fortë e kompanisë tuaj?**

Mendoj që trasparenca është çelësi i suksesit të një kompanie sigurimi dhe plotësimi i kërkesave të klientëve me produktet që duan ato. Por vlen të theksohet një fakt shumë domethenës. Ne kemi produktet europiane, por ama nuk kemi blerësin "europian".

Kjo ndodh për shumë arsye, por më kryesorja është mungesa e kulturës qytetare nga njëra anë dhe nga ana tjetër vazhdon akoma kujdesi i shtetit si në kohën e diktaturës,edhe për përmbytjen, edhe për zjarrin në shtëpi, edhe për sëmundjet, për pensionin, edhe për ndihmat etj.

Por pyetja që shtrohet është: Ku është standarti në këtë përkujdesje? Përgjigjien e dimë të gjithë...

Sa më i fortë të jetë individi aq më i pavarur bëhet nga shteti dhe aq më shumë liri demokratike ka një vend.

Hidhni një sy nga vendet e zhvilluara dhe shikoni njerëzit që jetojnë atje. Ata nuk duan ta dinë për politikën, nuk duan t'ja dinë se kush është ministër apo se kush është kryeministër dhe jo në pak raste nuk e dinë fare se kush e drejton shtetin e tyre. Jo si në Shqipëri ku e gjithë familja, duke filluar nga fëmijët e deri tek i moshuari, gozhdohen përpara televizionit në zgjedhje dhe presin me ankth se cila parti do fitojë e se kush do bëhet kryeministër. Nëpër botë, qytetarët shohin shoqëritë e sigurimi, bankat, fondet e pensioneve, shohin shërbimet që ju duhen.

Ne si SIGAL UNIQA jemi të fokusuar tek nevojat dhe pritshmëritë e klientëve.

Ne jemi gjithmonë një hap përpara kur bëhet fjalë për produkte të reja, për modernizim të sistemit, për përgatitje të stafit, për ofrimin e shërbimit cilësor, duke ju përshtatur nevojave të kohës dhe të klientëve. Nisur nga kjo ne po i kushtojmë një rëndësi të veçantë zhvillimit të teknologjisë, me fokus tek shërbimet online.

Paralel me produktet novatore që ne lançojmë në treg dhe me përmirësimin e vazhueshëm të shërbimit që ne ofrojmë, thelbësore është pagesa në kohë dhe në mënyrë korrekte e dëmeve. Tek e fundit ky është edhe qëllimi i ekzistencës së kompanive të sigurimit, ndaj për ne është parësore që çdo klient i cili pëson dëm të ndiqet dhe ti shërbehet me përpikmëri.

3. **Tregu i sigurimeve mbetet më i ulëti në rajon dhe më pak i zhvilluari. Pse ndodh kjo dhe cilat janë sugjerimet tuaja për të rritur madhësinë e tregut dhe për ta diversifikuar atë. Te cilat shërbime janë potencialet më të mëdha?**

E thashë edhe më lart, ka shumë arsye për këtë, por themelore mbetet kultura dhe roli i shtetit.

Shteti duhet të bëjë ligje direkte apo indirekte, të mbrojë interesat e qytetarëve, populli duhet të mbrojë pasurinë, shëndetin dhe pronën e tij financiarisht. Kjo e rregullon trendin e sotëm dhe natyrishtgjërat vijnë ngadalë dhe me kujdes .

Kryerja e reformave reale në këtë fushë është e rëndësishme dhe në fund shteti është më i lirë financiarisht. Sepse nuk është se ne po shpikim diçka të re, ne kemi shinat e shtruaradhe do zhgjedhim trenin, por që fatkeqësisht tek ne treni nuk lëviz siç duhet, është ende i ngadaltë dhe rrimë në stacion.

Reforma pa futjen e partneriteve private dhe kalimin tërësisht në ekonomi tregu dhe pa privatizim të sektorëvenuk mund të ketë. Nëse nuk hyjnë këto elementënë tregjet përkatëse është njësoj sikur të ndryshosh listën, ta bësh nga sipas moshës, sipas rendit alfabetik apo diçka tjetër.Ajo nuk është reformë!

4. ***Cilat janë planet për të ardhmen në drejtim të zgjerimit, investimeve, produkteve të reja?***

    Po bëhen gati 20 vjet që nga koha e themelimitt të SIGAL, një kompani e konsoliduar, me shumë medalje, me shumë vlerësime, me shumë arritje, ndoshta nuk do ta ekzagjeroja po të thoja që është një shembull për tu ndjekur për punën, stafet, njerëzit, marrëdhëniet etj.

    Ajo që do ndodhë këto vite do jetë interesante. Shitjet online dhe investimet në këtë fushë do jenë pa kufij.

    Ndaj, le të ecim për t'ua bërë më të thjeshtë jetën qyetarëve dhe së bashku me shërbimet t'i japim edhe më shumë besim njëri-tjetrit.

**14.07.2017**

**Ngjarje e rrallë, për herë të parë sot në Bajram Curri**

Shqipëria e viteve '90? Si ka qenë? Çfarë misteresh mbart? Ndryshimet rrënjësore që pësoi jeta e shqiptarëve; Ngarkesa historike e psiko-sociale e një kombi të çliruar nga kthetrat e regjimit më të egër që kishte njohur e përjetuar deri më atë kohë vendi ynë; Qytetarë të përvuajtur, familje në skamje, lëngimet e jetës së përditshme, por edhe dritëhije gati-gati të padukshme të grimcave të lumturisë të së përditshmes janë vetëm një pjesë e përshkrimit të historisë dhe të jetës së shqiptarëve që na e risjell në vemëndje, nëpërmjet fotografive reale e të gjalla, historiani, antropologu dhe fotografi i mirënjohur austriak Robert Pichler.

Të thëna e të pathëna, të dukshmet e sidomos të padukshmet e jetës së shqiptarëve të veriut të Shqipërisë, dokumentime të ngjarjeve të rëndësishme historike, por jo vetëm. Robert Pichler fotografon vazhdimësinë e jetës Shqiptare përtej përfshirjes së njerëzve në ngjarjet politike.

Ku flinin, çfarë hanin, si gëzonin e si hidhëronin, ku shkonin dhe me çfarë shkonin? Këto dhe shumë fragmente të tjera të jetës reale dhe të së përditshmes së shqiptarëve janë pasqyruar për herë të parë në një ekspozitë që do të çelet sot në qytetin e Bajram Currit.

**Më 14 korrik, ora 20:00**, zhvillohet inaugurimi i ekspozitës së parë të kësaj natyre, dhe që do të jetë e hapur deri më datë 10 shtator**, në ambientet e Muzeut Historik në Bajram Curri, Tropojë.**

Kjo ekspozitë do të shoqërohet edhe me një tjetër ekspozitë lëvizëse, krejt e veçantë dhe e parealizuar deri më tani në vendin tonë. Imazhet e ngjarjeve të viteve '90 do të projektohen në një ekspozitë lëvizëse në stacionin interurban Tiranë-Bajram Curri-Kosovë, ku furgonët e kësaj linje do të mbartin pas vetes imazhe të pashfaqura më parë, të cilat tregojnë marrëdhëniet sociale dhe jetën e njerëzve të atyre viteve.

Por e gjitha kjo nuk do të mund të ishte realizuar pa mbështetjen financiare të kompanisë më të madhe në Shqipëri dhe rajon, liderit të sigurimeve, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe kujdesit të veçantë të vetë drejtorit të SIGAL, Avni PONARI.

SIGAL UNIQA që prej themelimit të saj më 1999, ka qenë dhe mbetet gjithmonë promotori i historisë, kulturës dhe trashigimisë kulturore të vendit tonë, jo vetëm brenda kufijve por edhe jashtë tyre, kudo nëpër Europë dhe botë.

Një komb që harron është i destinuar të vdesë! Ndaj na takon të gjithëve që të kontribuojmë në mbajtjen gjallë të historisë së vendit tonë dhe ta risjellim në vëmendje herë pas here për brezat që do të vijnë.

Robert Pichler, autori i ekspozitës, është Historian, Antropolog  dhe Fotograf. Fushat kryesore të kërkimit të tij janë, familja dhe marrëdhëniet farefisnore, migrimi dhe transnacionalizmi, si edhe historia politike e shekullit 19-të dhe 20-të në Europën Juglindore. Ai është momentalisht studiues në departamentin e studimeve ballkanike në Akademinë e Shkencave në Vienë, si edhe pedagog në Qendrën e Studimeve të Europës Juglindore në Graz.

UNIQA > Njoftime per shtyp > Tiranë më, 18.05.2017

## Tiranë më, 18.05.2017

**10 vjet nga hyrja e të parit investitor strategjik në tregun shqiptar të sigurimeve**

***Lideri i tregut të sigurimeve në Shqipëri, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe gjigandi austriak UNIQA 10 vjet bashkëpunim***

Kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri SIGAL UNIQA Group AUSTRIA shënon sot 10-vjetorin e futjes në tregun shqiptar të sigurimeve të një prej kompanive lider në Europën Qendro-Lindore, UNIQA Insurance Group. Në vitin 2007 UNIQA vendosi të blejë një pjesë të aksioneve të SIGAL, duke u kthyer kështu në një partner kyç për SIGAL, por edhe një faktor të rëndësishëm për tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon.

SIGAL gëzon meritën për futjen në tregun shqiptar të sigurimeve të të parit investitor strategjik europian në industrinë e sigurimeve, me një potencial të jashtëzakonshëm dhe me një eksperiencë mbi 200-vjeçare në fushën e sigurimeve. Futja e UNIQA-s në industrinë e sigurimeve në Shqipëri ka qenë jo vetëm një garanci për tregun shqiptar, por edhe një indikator që ka luajtur një rol të rëndësishëm në rritjen dhe përmirësimin e tregut tonë të sigurimeve dhe në ndryshimin e opinionit publik për shoqërite e sigurimeve , sikundër ka ndikuar jo pak edhe në ekonominë shqiptare.

“Ne jemi të lumtur që UNIQA na besoi ne 10 vite më parë, për të investuar në tregun e sigurimeve vendas përmes kompanisë tonë SIGAL, dhe sot e them me bindje dhe krenar që kjo ka qenë një nga vendimet më të mira që unë kam marrë në fushën e biznesit, sepse të bashkëpunosh me një kompani si UNIQA Insurance Group është jo vetëm një siguri dhe sukses për ne si kompani, për SIGAL-in, por edhe një vlerë e shtuar, një aset tejet me vlerë për të gjithë tregun tonë dhe një impuls shumë i mirë për ekonominë e Shqipërisë, sikundër është një garanci financiare e rëndësishme për investitorët vendas dhe të huaj.

Me prezencën e UNIQA-s, SIGAL jo vetëm që është kompania lider në tregun e sigurimeve që nga krijimi i saj, por vazhdon të zotërojë 30% të tregut edhe pse numri i kompanive që operojnë në këtë industri është rritur dhe sot numërohen numërohen 8 kompani jo-jetë dhe 3 kompani jetë.

Udhëheqja e tregut, ka qenë jo vetëm në market-share, por ç’ka është më e rëndësishmja udhëheqja e tregut ka qenë në cilësinë e produkteve, në cilësinë e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe në pagesën në kohë dhe sipas ligjit të dëmeve.

Të qenit gjithmonë korrekt dhe pranë klientëve, të qenit inovator në krijimin e produkteve të dobishme dhe sipas nevojave e kërkesave të klientëve, na ka bërë ne të suksesshëm dhe të jemi gjithmonë lider në

këtë industri dhe një hap përpara konkurrentëve tanë.

Ne kemi bërë shumë deri më tani për ta rritur e zhvilluar tregun shqiptar të sigurimeve. Futja e UNIQA-s i ka dhënë një tjetër dimension dhe garanci europiane tregut tonë, po përpiqemi ti bëjmë sigurimet pjesë të jetës dhe të kulturës së shqiptarëve si një domosdoshmëri për një jetë më të qetë. Ne po përpiqemi për të forcuar dinjitetin njerëzor dhe pavarësinë individuale të qytetarëve nga shteti dhe strukturat e tij, për ta bërë qytetarin më të pavarur dhe dinjitoz në jetën e përditshme dhe kjo arrihet vetëm kur sigurimet janë në nivelet europiane ndërsa përgjegjësitë dhe përfitimet janë të qytetarëve. Tani mendoj dhe besoj se ka ardhur koha që edhe instancat e duhura shtetërore të bëjnë pak më shumë për ta zhvilluar më tej këtë industri, një industri me një peshë shumë të madhe në ekonominë tonë", -tha ndër të tjera, CEO i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë, Z. Avni PONARI.

Nga ana e tij, CEO i UNIQA-s, Z. Wolfgan KINDL tha se kompania që ai përfaqëson e ka në prioritet Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë dhe do të vazhdojë të investojë në tregjet e këtyre shteteve. Kindl shprehu bindjen për mbështetjen e qeverisë Shqiptare për ndërmarrjen e incentivave për përmirësimin dhe zhvillimin e industrisë së sigurimeve, pasi sipas tij kjo industri luan një rol të rëndësishëm dhe ka një potencial të madh për tu zhvilluar, por ka nevojë për një tjetër shtytje edhe nga ana e qeverisë dhe e shtetit.

Ky takim i një rëndësie të veçantë mblodhi në Tiranë mbi 40 drejtuesë dhe menaxherë mediash dhe PR të UNIQA-s nga 19 shtete europiane, me në krye CEO-n e UNIQA-s Z. Wolfgang KINDL, të cilët me ftesën e Z. PONARI, erdhën dhe vizituan Shqipërinë për disa ditë me radhë. Qëllimi i këtij turi ishte promovimi i artit, kulturës, historisë dhe turizmit të vendit tonë, si një mënyrë dhe mundësi e shkëlqyer që vlerat dhe trashëgimitë e vendit tonë të përçohen kudo në Europë e nëpër botë.

Në këtë takim morën pjesë gjithashtu personalitetet më të larta të ekonomisë dhe financave në Shqipëri, Ambasadori i Austrisë në Shqipëri, SH. T.Z. Johann Sattler si dhe përfaqësuesë të institucioneve dhe bizneseve austriake në Shqipëri e shumë drejtuesë e personalitete të tjera shqiptarë dhe të huaj.

**Mbi SIGAL UNIQA Group Austria**

SIGAL UNIQA është kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri, me një shtrirje edhe në Kosovë e Maqedoni. Që prej vitit 2002, SIGAL udhëheq tregun shqiptar të sigurimeve, me rreth 30%. Pavarësisht shtimit në numër të kompanive të sigurimit, SIGAL e ka ruajtur pozicionin si lider të tregut, vetëm në sajë të shërbimeve më të mira ndaj klientëve, nëpërmjet produkteve me interes ofruar tek qytetarët dhe pagesës së dëmeve në kohë dhe në vlerën e duhur sipas ligjit.

Me rreth 840 mijë kontrata në vit, mbi 152 milionë euro dëme të paguara vetëm 10 vitet e fundit si dhe një volum primesh gjithmonë në rritje, lideri i sigurimeve udhëheq bindshëm tregun dhe është kompania më e besuar për shqiptarët.

Grupi SIGAL UNIQA numëron rreth 1200 punonjës dhe agjentë, zotëron 106 milionë euro asete dhe ka të gjitha parametrat financiarë në përputhje me kërkesat e ligjit.

Me futjen e UNIQA-s grupi SIGAL mori një tjtër hov zhvillimi, që ndikoi ndjeshëm në në rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve, në përmirësimin e infrastrukturës, krijimin e standarteve të europiane për

kompaninë dhe tregun në tërësi, sikundër kjo reflektoi edhe në rritjen e volumit të primeve por edhe në një rritjen e dëmshpërblimit në kohë rekord të klientëve.

Krahas përgjegjësisë kontraktuale duke paguar në kohë rekord dëmet, SIGAL UNIQA ka dhënë një kontribut shumë të madh për artin, kulturën dhe sportin në vend.

Në 10 vitet e fundit, që përkon edhe me bashkëpunimin me UNIQA-n, SIGAL UNIQA ka kontribuar mbi 2 milionë euro në promovimin dhe zhvillimin e sportit, artit, kulturës dhe aktiviteteve sociale.

**Mbi UNIQA GROUP AUSTRIA**

UNIQA GROUP është lider në tregun e sigurimeve të Austrisë dhe të Europës Qendrore dhe asaj Lindore. Mbi 20 mijë punonjës iu shërbejnë mbi 10 milionë klientëve në 19 shtete, nga të cilat 15 shtete të Europës Qendrore-Lindore. Gjigandi austriak i sigurimeve, me një histori mbi 200-vjeçare në tregun e sigurimeve, zotëron mbi 33 miliardë Euro asete dhe mbi 7 miliardë euro prime në vit.

UNIQA GROUP hyri në tregun shqiptar të sigurimeve në vitin 2007, nëpërmjet bashkëpunimit me kompaninë më të madhe në vend, SIGAL, duke u bërë kështu i pari investitor i huaj që futej në industrinë e sigurimeve në Shqipëri.






## 10 vite bashkëpunim SIGAL & UNIQA

Në kuadër të 10-vjetorit të hyrjes së, UNIQA Insurance Group, të parit investitor Europian në tregun shqiptar të sigurimeve përmes SIGAL, kompanisë lider në Shqipëri,

zhvillohet në Tiranë takimi:

"Investimet strategjike në fushën e sigurimeve dhe ndikimi në ekonominë shqiptare"

Me pjesëmarrjen e CEO të UNIQA International, Z. Wolfgang KINDL, CEO i SIGAL UNIQA për Shqipërinë, Kosovën e Maqedoninë, Z. Avni PONARI, përfaqësuesë të UNIQA-s nga 19 shtete Europiane dhe drejtuesë e përfaqësuesë të institucioneve shtetërore dhe financiare në Shqipëri.

**Datë 18 maj 2017**

**Ora 09.30**

**Salla Illyria II, Hotel Sherato**

## Prishtinë, më 01/11/2016

**SIGAL UNIQA KOSOVA vlerësohet me Medaljen e Mirënjohjes në 13-vjetorin e saj**

***Në ceremoni morën pjesë, CEO i SIGAL UNIQA, Z. Avni PONARI, Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, Znj. Hykmete BAJRAMI, Ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Z. Arsim BAJRAMI, Zëvendës-Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës Z. Fehmi MEHMETI, si dhe përfaqësuesë të tjerë të institucioneve shtetërore të shtetit të Kosovës.***

Kompania më e madhe e sigurimeve shqiptare, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, shënon 13-vjetorin e fillimit të veprimtarisë së saj në Kosovë.

SIGAL UNIQA Kosova u themelua më 23 Tetor 2003, duke shënuar rritje vit pas viti dhe duke u kthyer ndër kompanitë më të mëdha të tregut të sigurimeve në Kosovë. Në vitin 2015 SIGAL UNIQA Kosova zotëroi 15.86% të tregut, referuar të dhënave të Bankës Qendrore.

Në fjalën e tij, CEO i SIGAL UNIQA, Z. Avni PONARI, vuri theksin në kontributin e kompanisë në ekonominë e Kosovës, sikundër u shpreh se ndjehet krenar që jemi në Republikën së Kosovës.

“SIGAL u vendos këtu në periudhën e rëndësishme historike, kur Kosova e dalë nga lufta po ndërtonte institucionet e veta demokratike, zhvillonte ekonominë dhe biznesin e rrënuar dhe po rendte drejt shpalljes së pavarësisë. Sot pas kaq vitesh, kjo kompani krenohet që në logon e saj vendoset emri Republika e Kosovës dhe beson se ka bërë më të mirën e mundshme për të ndihmuar në zhvillimin e ekonomisë së kësaj Republike.

Ne filluam me pak kapital në vitin 2003, por që sot ka arritur 8 milionë Euro. SIGAL UNIQA numëron sot mbi 60 zyra në të gjithë Kosovën dhe mbi 250 punonjës e agjente me një pagë mesatare 700 Euro, të cilët ndihmojnë në ekonominë e familjeve të tyre, por edhe në ekonominë e vendit. Në 13 vite SIGAL UNIQA Kosova ka paguar mbi 33 milionë Euro dëme dhe rreth 6.5 milionë Euro taksa, ç’ka dëshmojnë potencialin e kësaj kompanie, por edhe seriozitetin me të cilin punon.

Pas 13 vitesh SIGAL UNIQA është krenare që solli në Kosovë investitorin strategjik të sigurimeve, UNIQA GROUP, duke i siguruar Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë garancinë e tregut të sigurimeve.

Trembëdhjetë vite udhëtim së bashku kanë qenë vite të vështira, por edhe të suksesshme dhe ne besojmë se një e ardhme më e sigurtë na pret të gjithëve. Mirënjohje dhe falënderime për secilin prej Jush, për ju që keni qenë me ne qysh prej fillimit e ju që jeni bashkangjitur gjatë rrugës në familjen e madhe të SIGAL UNIQA”, -u shpreh Z. PONARI.

“SIGAL është pjesë e UNIQA Group, një kompani me një eksperiencë mbi 200-vjeçare në tregun e sigurimeve, që prej 1811, e cila numëron mbi 21 mijë punonjës dhe zotëron 33 miliardë Euro asete dhe mbi 7 miliardë prime në vit, prezente në 21 shtete të Europës Qendrore dhe Lindore. I përmenda këto shifra për të treguar se një kompani serioze si UNIQA, nuk ka ardhur këtu për një, dy apo 10 vjet, por për qindra vite, sepse Kosova dhe rajoni janë potenciale të zhvillimit të kësaj industrie në të ardhmen.

Ne jemi këtu për të ndërtuar një treg modern sigurimesh, për të plotësuar interesat e klientëve dhe për të patur një kompani model në të gjitha drejtimet dhe jo vetëm në sigurime, por në të gjitha fushat.

Ne jemi pjesë e jetës sociale dhe sportive këtu në Kosovë, ku kemi shpenzuar 1.8 milionë Euro gjatë këtyre viteve, ku vetëm Sigal Prishtinën e kemi mbështetur me 1.4 milionë Euro, deri më tani dhe do të vazhdojmë të mbështesim, sportin, artin e kulturën e këtij shteti, për të cilin jam i bindur që secili prej jush ndjehet krenar për historinë e tij, ndërsa unë jam i lumtur që bashkëpunoj me Z. PONARI dhe që së bashku do të vazhdojmë të investojmë në zhvillimin e tregut të sigurimeve në këtë rajon”, - ka theksuar CEO i UNIQA Group, Z. Andreas BRANDSTETTER në takimin vjetor të SIGAL UNIQA.

Në pritjen e organizuar për nder të 13-vjetorit morën pjesë, Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, znj. Hykmete Bajrami, Ministri i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, z. Arsim Bajrami, Zëvendës-Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës z. Fehmi Mehmeti, si dhe përfaqësuesë të tjerë të institucioneve shtetërore të shtetit Kosovar.

Ministrja Bajrami, në emër edhe të Kryeministrit të Kosovës, Z. Isa Mustafa, falënderoi kompaninë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA për kontributin e dhënë në ekonominë e vendit dhe shprehu gadishmërinë e qeverisë për krijimin e një ambjenti makro-fiskal stabël dhe theksoi se do të dëgjojnë dhe përparësi këshillat dhe nevojat e biznesit për përmirësimin e tregut të sigurimeve në veçanti dhe të të bërit biznes në tërësi.

Në këtë event, Aleanca Kosovare e Bizneseve, në shenjë falënderimi për punën shumë të mirë të SIGAL UNIQA dhe për kontributin e dhënë përgjatë 13 viteve në Kosovë, i dorëzoi Drejtorit të Përgjithshëm të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, z. PONARI “Medaljen e Mirënjohjes”.

Më herët, u zhvillua edhe një konferencë për mediat, ku z. Ponari iu përgjigj interesit të gazetarëve.











UNIQA > Njoftime per shtyp > THIRRJE PËR APLIKIME

## THIRRJE PËR APLIKIME

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL fton të gjithë të interesuarit që kanë dëshirë dhe eksperiencë në leximet audio, të dorëzojnë materiale audio me lexime të librave të ndryshëm artistikë, kundrejt pagesës.

**Kriteret**:

- Materialet mund të jenë nga letërsia shqiptare ose e huaj; letërsi për fëmijë, ese, poezi, romane, novela etj;
- Materiali duhet të jetë në format elektronik, në CD dhe regjistrim në studio profesionale;
- Librat duhet të jenë të lexuar qartë dhe rrjedhshëm në gjuhën shqipe, të ndarë sipas kapitujve.

Së bashku me materialin elektronik, aplikanti duhet të dorëzojë:

- CV
- Marrëveshjen me subjektin që ka të drejtat e autorit për librin përkatës, në përputhje me Ligjin Shqiptar për Të Drejtat e Autorit
- Listë të librave që merr përsipër të regjistrojë

Materialet mund të dërgohen brenda datës 30 nëntor 2016, në adresën e mëposhtme:

**Klubi i Artit dhe i Kulturës SIGAL**

klubiiartit@sigal.com.al

Tel: 04 22 333 08

# Tiranë më, 20/06/2016

**Sigurimet për Bujqësinë**

**Firmoset marrëveshja ndërmjet FED Invest dhe SIGAL UNIQA Group AUSTRIA për sigurimin e fermerëve**

Kryetarja e Bordit Drejtues të "FED invest" znj. Zana Konini dhe Drejtori i Përgjithshëm i "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA" z. Avni Ponari firmosën sot marrëveshjen për fillimin e projektit pilot "sigurimi i serave si konstruksion".

Kjo marrëveshje ka për qëllim mbështetjen e prodhimit bujqësor nëpërmjet futjes dhe zhvillimit të produkteve të sigurimit në sektorin e bujqësisë. Marrëveshja në kuadrin e një projekti pilot u realizua me financimin e Shoqërisë Kursim Kredi "FED invest" dhe në bashkëpunim me SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a., e cila mori përsipër sigurimin e serave të 757 fermerëve nga i gjithë vendi.

Qëllimi i projektit është ndërgjegjësimi i fermerëve për futjen dhe zhvillimin e sigurimeve në bujqësi e blegtori, i konsideruar si instrument mbrojtës kundër dëmeve që shkaktojnë rreziqet natyrore në investimet e tyre dhe asetet e krijuara për prodhimin bujqësor. Rastet e katastrofave natyrore, të ndodhura disa herë në vit, janë shoqëruar me pasoja të rënda ekonomike për fermerët dhe blegtorët. Ky projekt pilot dhe zgjerimi i tij me një numër më të konsiderueshëm të fermerëve dhe blegtorëve mbetet një nevojë e domosdoshme për të siguruar investimet e bëra me aq mund nga fermerët e blegtorët.

Faza e parë e këtij projekti pilot është fokusuar në sigurimin e serave të prodhimit bujqësor, të ndërtuara me financim të FED Invest sh.k.k. dhe të fermerëve anëtarë të saj. Serat janë të siguruara tek SIGAL UNIQA Group AUSTRIA nga dëmet që mund të shkaktojnë rreziqet si breshëri, stuhia, shtrëngatat dhe përmbytjet. Është për tu theksuar fakti se në këtë fazë të projektit pilot, në mbështetje të drejtë-përdrejte të fermerëve në një formë të prekshme, detyrimi për pagesën e primit të sigurimit është marrë përsipër dhe është paguar nga FED Invest sh.k.k.

FED Invest dhe SIGAL UNIQA Group AUSTRIA falënderuan Ministrinë e Bujqësisë, dhe në veçanti z. Panariti, për kujdesin e veçantë të treguar për ta mbështetur iniciativën për realizimin e këtij projekti pilot si dhe për mbështetjen e ardhshme për zgjerimin e skemës së sigurimit, si për sa i përket numrit të fermerëve dhe blegtorëve, apo edhe produkteteve të siguruara. Gjithashtu është për tu vlerësuar vëmendja e Ministrisë së Bujqësisë për domosdoshmërinë e mbështetjes dhe nxitjes së mëtejshme të zgjerimit të projektit, me qëllim që gradualisht të kalohet jo vetëm në sigurimin e serave, por të shtrihet në sigurimin e pajisjeve të fermerëve dhe blegtorëve, në sigurimin e bagëtive dhe shpendëve si dhe në sigurimin e prodhimit bujqësor.

I pranishëm në ceremoninë e firmosjes së marrëveshjes në fshatin "Krutje" të Lushnjes, Ministri Panariti falënderoi Drejtorin e Përgjithshëm të SIGAL UNIQA, z. Ponari, për mbështetjen që po i jep bujqësisë, duke siguruar me dhjetëra fermerë në të gjithë Shqipërinë. Ministri e cilësoi këtë si ditë historike dhe shprehu mbështetjen e Ministrisë së Bujqësisë për ta zgjeruar më tepër këtë projekt.

Nga ana e tij, Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, z. Avni Ponari vuri theksin tek domosdoshmëria për sigurimet, në mënyrë që qytetarët në rastet e dëmeve dhe katastrofave të mos enden ndyerve të shtetit, duke humbur kështu edhe personalitetin e tyre. Z. Ponari tha se industria e sigurimeve duhet mbështetur dhe duhet të jetë më e pavarur nga instancat shtetërore.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është e vetmja kompani, e cila ofron për klientët të gjitha klasat e sigurimit, me 42 produkte në treg. Duke qenë pjesë e gjigandit austriak të sigurimeve UNIQA Group, SIGAL UNIQA i ka të gjitha kapacitetet financiare për të mbuluar çdo lloj sigurimi në Shqipëri dhe më gjerë në rajon, përfshirë këtu edhe katastrofat natyrore.


FED invest
SIGAL
UNIQA GROUP AUSTRIA
Projekt pilot "Sigurimi i Serave Konstruksion" për anët





UNIQA > Njoftime per shtyp > THIRRJE PËR APLIKIME

# THIRRJE PËR APLIKIME

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL fton të gjithë të interesuarit që kanë dëshirë dhe eksperiencë në leximet audio, të dorëzojnë materiale audio me lexime të librave të ndryshëm artistikë, kundrejt pagesës.

**Kriteret**:

- Materialet mund të jenë nga letërsia shqiptare ose e huaj; letërsi për fëmijë, ese, poezi, romane, novela etj;
- Materiali duhet të jetë në format elektronik, në CD dhe regjistrim në studio profesionale;
- Librat duhet të jenë të lexuar qartë dhe rrjedhshëm në gjuhën shqipe, të ndarë sipas kapitujve.

Së bashku me materialin elektronik, aplikanti duhet të dorëzojë:

- CV
- Marrëveshjen me subjektin që ka të drejtat e autorit për librin përkatës, në përputhje me Ligjin Shqiptar për Të Drejtat e Autorit
- Listë të librave që merr përsipër të regjistrojë

Materialet mund të dërgohen brenda datës 30 nëntor 2016, në adresën e mëposhtme:

**Klubi i Artit dhe i Kulturës SIGAL**

klubiiartit@sigal.com.al

Tel: 04 22 333 08

UNIQA > Njoftime per shtyp > Tiranë më, 28.04.2016

## Tiranë më, 28.04.2016

### SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA sponsor zyrtar i Kombëtares Shqiptare

***Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, Z. Avni Ponari firmosi sot kontratën me Presidentin e FSHF-së, nëpërmjet së cilës SIGAL UNIQA zotohet të mbështesë Kombëtaren Shqiptare duke u bërë sponsor zyrtar i saj.***

Duke filluar nga dita e sotme, kompania më e madhe e sigurimeve në vend, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, do të mbështesë Kombëtaren Shqiptare, duke u bërë kështu sponsor zyrtar i saj. Marrëveshja u firmos sot, nga Drejtori i Përgjithshëm i kompanisë SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari dhe Presidentit të Federatës Shqiptare të Futbollit, Z. Armand Duka.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në praninë e mediave, Z. Ponari u shpreh: "Ndër vite ne kemi mbështetur disiplina të ndryshme të sportit në tërësi, duke filluar me futbollin, basketbollin, athletikën, alpinizmin, aeronautikën etj, por të mbështesësh Kombëtaren Shqiptare është krejt tjetër gjë. Djemtë e kombëtares janë krenaria jonë kombëtare, janë ambasadorët tanë më të mirë nëpër botë dhe ne jemi të lumtur që i mbështesim ata. Talentët kuq e zi na plotësuan ëndrrën europiane duke na kualifikuar në Euro 2016, ndaj ne ua kishim 'borxh' këtë suport. Me kontratën e firmosur sot me Presidentin Duka, kompania që unë drejtoj, SIGAL UNIQA angazhohet të ofrojë mbështetjen e saj për Kombëtaren Shqiptare".

Më tej, Z. Ponari u bëri thirrje edhe kompanive të tjera që ta mbështesin sportin e në mënyrë të veçantë vuri theksin tek politikat lehtësuese fiskale që duhet të ndërmarrë shteti ndaj sportit.

"Mund ta them me plot gojën që SIGAL ka dëshmuar se mbetet jo vetëm kompania lider në sigurime, por edhe kompania lider në mbështetjen dhe zhvillimin e sportit në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Unë do t'i ftoja të gjitha kompanitë e tjera, të gjitha bizneset në vend që ta mbështesin sportin, pasi aty është e ardhmja e rinisë, e ardhmja e talenteve shqiptare, të cilët duhen ndihmuar e promovuar. Nga ana tjetër, duhet që edhe shteti të luajë rolin e tij nëpërmjet politikave fiskale lehtësuese, në mënyrë që sporti në Shqipëri të marrë vendin që i takon dhe Shqipëria të garojë denjësisht në arenat ndërkombëtare. Djemtë tanë kanë bërë më të mirën e tyre, tani është radha jonë që të bëjmë detyrën tonë morale, është radha e shtetit të bëjë detyrën e tij, në mënyrë që t'i ndihmojmë talentet shqiptare të korrin sa më shumë suksese", -tha Ponari gjatë ceremonisë së firmosjes së kontratës, ku ishin të pranishëm kryesia e FSHF-së, trajneri De Biasi dhe lojtarët e Kombëtares.

I pyetur nga mediat, Ponari bëri me dije se, së bashku me Presidentin Duka kanë firmosur edhe një tjetër kontratë, atë të sigurimit të Federatës Shqiptare të Futbollit. SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ka marrë kështu nën mbrojtje djemtë e kombëtares dhe jo vetëm. Pjesë e kontratës, nga e cila do të përfitojnë sigurimin e shëndetit, janë edhe të gjitha ekipet e grupmoshave, të gjitha ekipet e Superligës Shqiptare si dhe i gjithë stafi i FSHF-së.

“Me këtë kontratë, ne zotohemi të marrim nën mbrojtje, duke siguruar rreth 500 lojtarë të të gjithë Federatës Shqiptare të Futbollit si dhe stafin drejtues të Federatës. Është hera e parë që sigurohet Federata Shqiptare e Futbollit dhe jemi krenarë që talentet shqiptare, përfshirë edhe kombëtaren, na u besuan ne”, -shtoi më tej Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, përveç detyrimeve kontraktuale me klientët e saj, ka qenë gjithmonë partnere e sportit, arsimit, artit e trashëgimisë kulturore në Shqipëri, duke mbështetur financiarisht aktivitete të ndryshme.

Ndër të tjera, SIGAL UNIQA është: Sponsor Zyrtar i Federatës Shqiptare të Basketbollit; Sponsor Zyrtar i SIGAL UNIQA Balkan League; Sponsor i Klubit të Basketbollit Valbona; Sponsor i skuadrës kampione SIGAL Prishtina; Mbështetje financiare për kampionen e atlethikës Luiza Gega; Mbështetje financiare për Aeronautikën dhe Alpinizmin Shqiptar; Mbështetje për maratonën “Run4Austism” e organizuar për të mbështetur personat të prekur nga autizmi etj.

Një vëmendje të veçantë, SIGAL UNIQA i ka kushtuar edhe kujdesit shëndetësor, duke ndërtuar të parën dhe të vetmen klinikë mjekësore lëvizëse në Shqipëri. Me një staf mjekësor profesional, në klinikën lëvizëse të SIGAL UNIQA mundësohen një shumëllojshmëri ekzaminimesh për klientët e saj dhe jo vetëm.

Klinika u promovua në skajin verior të Shqipërisë, në Valbonë dhe më pas iu drejtua Vermoshit duke ju ofruar banorëve të zonës shërbimet bazë mjekësore falas, shërbime të cilat për arsye ekonomike apo infrastrukturore banorët e kanë të vështirë ti marrin.  Klinika mjekësore do të jetë prezente në çdo cep të Shqipërisë, si dhe në Kosovë e Maqedoni.

Për kontributin e dhënë në përmbushjen e përgjegjësive së saj sociale, SIGAL UNIQA u nominua nga Qeveria Shqiptare në eventin gala të sipërmarrësve më të mirë të vitit, “Bleta e Artë 2015”,  për çmimin “Sipërmarrje në Kulturë”, si një ndër katër kompanitë më të mira që ka mbështetur artin dhe kulturën në vend.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA, që prej vitit 2002  udhëheq tregun e sigurimeve me mbi 30% të tregut, në të cilin operojnë 11 kompani sigurimesh, ku kompania që renditen e dyta zotëron vetëm 13% të këtij tregu. SIGAL UNIQA, e vetmja kompani e licensuar për të gjitha klasat e sigurimit dhe me 42 produkte në treg, është pjesë e UNIQA Insurance Group, kompanisë lider në Europën Qendrore dhe Lindore në fushën e sigurimeve dhe investimeve. UNIQA numëron 7 miliardë Euro të ardhura vjetore dhe me mbi 27 miliardë Euro asete në menaxhim.

UNIQA > Njoftime per shtyp > Tiranë më, 11.04.2016

## Tiranë më, 11.04.2016

**Vdekja e ushtarakëve të FA-së, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dëmshpërblen familjarët e viktimave**

Pas ngjarjes së rëndë, të ndodhur me dy ushtarakët e Forcave të Armatosura në Grizhë të Malësisë së Madhe, SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA ka dëmshpërblyer familjarët e viktimave. Kompania më e madhe e sigurimeve në vend, dëmshpërbleu familjarët e kapiten Florian Deliajt dhe toger Donald Hoxha, me shumën 180 milionë Lekë për secilën familje.

Anëtarët e Forcave të Armatosura të Shqipërisë janë të siguruar tek kompania e sigurimeve SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Life. Edhe kapiten Florian Deliaj dhe toger Donald Hoxha, si pjesë e FA-ve, ishin të siguruar tek kompania SIGAL UNIQA Life, e cila iu është përmbajtur detyrimeve të saj kontraktuale, duke dëmshpërblyer familjarët e viktimave menjëherë pas ngjarjes tragjike që u mori jetën dy Dëshmorëve të Atdheut.

SIGAL UNIQA bashkohet me dhimbjen e thellë të familjarëve që humbën jetën në aksidentin me helikopterin e Forcave të Armatosura, duke shpresuar që me çekun e dorëzuar familjarëve t'ju vijë në ndihmë moralisht e financiarisht dhe tu lehtësojë atyre sadopak dhimbjen për humbjen e njerëzve të dashur.

Është hera e parë që në Shqipëri dëmshpërblehen jetët e humbura të dy ushtarakëve të Forcave të Armatosura. Kompania SIGAL UNIQA Group AUSTRIA thekson se iu është përmbajtur me përpikmëri detyrimeve të saj kontraktuale.

“Nuk do të dëshironim kurrë që me familjarët e klientëve tanë të takoheshim në këtë lloj situate, siç ndodhi me familjet e dy ushtarakë, por fatkeqësisht jetën e kapiten Florianit dhe toger Donaldit nuk mundet ti kthejmë mbrapsh. Ajo që ne mundet të bëjmë, është që t'u gjendemi pranë si moralisht ashtu edhe financiarisht familjarëve të tyre, duke shpresuar që me çekun që iu akorduam ti lehtësojmë ata nga pikëpamja financiare, pasi siç e thashë dhe më lart jetët e humbura nuk kthehen më. Shpreh ngushëllimet më të përzemërta në emrin tim personal dhe të kompanisë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe u themi familjarëve të dy dëshmorëve të atdheut se jemi pranë tyre dhe bashkohemi me dhimbjen e pashterueshme që ata kanë në këto momente”, -u shpreh Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, z. Avni Ponari.

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA është kompania më e madhe në tregun e sigurimeve në Shqipëri, me rreth 35% të tregut dhe është cilësuar si kompania me shërbimin më të mirë ndaj klientit dhe që paguan dëmet në kohë. Vetëm për vitin 2015, SIGAL UNIQA ka dëmshpërblyer në një vlerë totale klientët e saj prej rreth 18 milionë Euro.

**Drejtoria e Përgjithshme**

Qendra e Biznesit SIGAL

Blv. Zog I , Nr 1

Tirana – Albania

Phone: +355 4 2233308

Fax: +355 4 2250220

E-mail: info@sigal.com.al

Website: www.sigal.com.al

# Tiranë 02/04/2016

## SIGAL UNIQA mbështet "Run4Autism Albania"

Kompania më e Madhe e Sigurimeve në vend, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, u solidarizua dhe mbështeti kauzën "Run4Autism", e cila synon të ndërgjegjësojë të gjithë qytetarët shqiptarë për personat që janë të prekur nga kjo sindromë. Në vendin tonë janë 58 mijë fëmijë dhe të rritur të prekur nga sindroma e Autizmit, ndaj të gjithë së bashku mund të solidarizohemi me ta dhe ti ndihmojnë sado pak.

SIGAL UNIQA, me kujdesin e veçantë të Drejtorit të Përgjithshëm, Z. Avni Ponari, iu bashkua kësaj kauze, ku përveç mbështetjes financiare të dhënë nga kompania, Klinika Lëvizëse SIGAL UNIQA u vu në dispozicion të pjesëmarrësve të maratonës më datë 2 prill 2016, ndërsa stafi i kompanisë iu bashkua maratonës në shenjë solidarizimi.

SIGAL UNIQA ka dëshmuar gjithmonë se, përveç shërbimit korrekt ndaj klientëve të saj, është një kompani e cila mbështet kauza sociale dhe kulturore. Për kontributin e dhënë në këtë drejtim, në dhjetor 2015, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA u nominua nga Qeveria Shqiptare, në eventin gala të sipërmarrësve më të mirë, "Bleta e Artë 2015", për çmimin "Sipërmarrje në Kulturë", si një nga katër kompanitë më të mira, e cila ka mbështetur artin dhe kulturën, evente të tjera sociale në vend.

UNIQA > Njoftime per shtyp > Tiranë, 22/02/2016

## Tiranë, 22/02/2016

### 17 vjet SIGAL UNIQA

Bëhen plot 17 vjet që nga vitit i themelimit të SIGAL UNIQA. Përgjatë gjithë këtyre viteve kemi udhëhequr bindshëm tregun e sigurimeve dhe kjo falë besimit të mbi një milion klientëve. Që prej vitit 2002 SIGAL UNIQA udhëheq tregun e sigurimeve në Shqipëri me rreth 35% të të gjithë tregut.

Që nga viti i themelimit, përveç përgjegjësisë kontraktuale ndaj klientëve ku ka paguar rreth 130 milionë Euro dëme ndër vite, SIGAL UNIQA i ka kushtuar një rëndësi të veçantë mbështejes për shëndetin, artin dhe kulturën në vend, pa harruar edhe promovimin e Shqipërisë.

**Promovimi i shëndetit të mirë!**

Është më mirë të parandalosh një sëmundje sesa ta kurosh atë! Nisur nga kjo filozofi, në vitin 2015 SIGAL UNIQA Group AUSTRIA erdhi me një risi të re në fushën e shëndetit: ndërtoi Klinikën Lëvizëse SIGAL UNIQA. E para dhe e vetmja e këtij lloji në Shqipëri, klinika lëvizëse ofron shërbime shëndetësore falas për klientët dhe qytetarët. Klinika u promovua në skajin verior të Shqipërisë, në Valbonë, ku banorëve të zonës iu mundësuan një shumëllojshmëri ekzaminimesh, duke filluar që nga vizitat, echot, matje sheqeri, vizitë ORL etj.  E konceptuar si një klinikë që ofron shërbimet bazë diagnostikuese, klinika lëvizëse do të jetë në çdo cep të Shqipërisë, duke sensibilizuar qytetarët për kujdesin ndaj shëndetit. Në kuadër të promovimit shëndetësor, SIGAL UNIQA ka hapur Klubin e Shëndetit VitalClub, ku marrin trajtime fizioterapeutike qindra klientë të saj.

**Arti dhe kultura**

Në simbol të dëshirës për të mbështetur artin dhe kulturën në vend, në vitin 2010 SIGAL UNIQA themeloi Klubin e Artit dhe Kulturës në Durrës, i cili është unik për nga lloji në të gjithë Shqipërinë. Në dhjetor 2015, SIGAL UNIQA çeli ekspozitën "UNIQ'Art", me karikatura të punuara nga profesor Bujar Kapexhiu (Mjeshtër i Madh), të cilat shprehnin rëndësinë e produkteve të sigurimit, si një kulturë që duhet zhvilluar në vendin tonë dhe për më tepër si një domosdoshmëri që dikton koha.

Folklori dhe trashëgimia kulturore janë pjesë e rëndësishme e indentitetit tonë kombëtar, ndaj për të kontribuar sado pak në këtë fushë, SIGAL UNIQA ka mbështetur: Festivalin Mbarëkombëtar Folklorik të Gjirokastrës "Argjiro Fest-On"; Festivali Operistik Marije; Takimi Muzikor i Dy Botëve", Ekspozitën Ndërkombëtare "Milan Expo 2015" si dhe edicionin e 21 të Ekspozitës Ndërkombëtare të Arteve Pamore Onufri, 2015. Koncerti Simfonik, me pjesëmarrjen e Shkëlzen Dolit-pjesëtar i Filarmonisë së Vjenës dhe njëherësh autorit të 'Shpirti Shqiptar', e cila hapi siparin e Koncertit të Vjenës në fillim-vitin 2015 është një tjetër aktivitet i mbështetur nga SIGAL UNIQA, po ashtu edhe Different Trains Festival.

**Arsimi**

Me bindjen se investimi tek arsimi dhe edukimi sa më i mirë i brezit të ri është kontributi më i shkëlqyer për vendin tonë, SIGAL UNIQA ka mbështetur vazhdimisht institucione arsimore, nëpërmjet dhënies së bursave të studimit, si në rastin e bursave në Shkollën Austriake Shkodër, pajisjen me mjete mësimore dhe kompjutera për shkollën 9-vjeçare në Vermosh, si dhe ndihmesë për rikonstruktimin e disa shkollave 9-vjeçare në zonat rurale të vendit. Gjithashtu, publikimi i librit të At Zef Pllumit 'Rrno për me tregue' u bë i mundur falë mbështetjes së SIGAL UNIQA.

**Sporti**

Një vëmendje të veçantë i është kushtuar aktiviteteve sportive, si basketbollit, futbollit, alpinizmit etj. SIGAL UNIQA është mbështetëse zyrtarë të Federatës Shqiptare të Basketbollit, përmes së cilës janë iniciuar projekte dhe aktivitete për përfshirjen e të rinjve në sport. Skuadra kampione e basketbollit kosovar mban emrin "SIGAL Prishtina", ndërsa që prej disa muajsh, Liga Ballkanike e Basketbollit është riemërtuar SIGAL UNIQA Balkan League, emër të cilin do ta mbajë për një periudhë 3-vjeçare.

**Promovimi i Shqipërisë**

Me dëshirën për promovimin e Shqipërisë dhe të vlerave që ajo mbart, në vitin 2015, me ftesë të SIGAL UNIQA, Klubi Rotarian Austriak, i cili përbëhet nga investitorë e binzesmenë të rëndësishëm austriakë, vizituan për herë të parë Shqipërinë. Për disa ditë me radhë, pjesëtarët e Klubit Rotarian Austriak eksploruan bukuritë natyrore dhe trashëgiminë e pasur kulturore të vendit tonë. Me vlerësimin maksimal për trashëgiminë kulturore SIGAL UNIQA ka bërë të mundur rindërtimin e ndërtesave karakteristike në Berat, Pogradec dhe Korçë, duke i rikthyer qyteteve disa prej pasurive më të mëdha arkitekturore.

Në 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, në bashkëpunim me UNIQA Insurance Group dhe Muzeun e Vjenës, SIGAL UNIQA bëri të mundur risjelljen në Shqipëri të Armëve të Skënderbeut dhe koleksionin e plotë me vlerë 35 milionë Euro.

UNIQA > Njoftime per shtyp > Tiranë më, 18.02.2016

## Tiranë më, 18.02.2016

**Njoftim për Mediat**

**SIGAL UNIQA mbështet kampionen e athletikës, Luiza Gega**

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ka kënaqësinë të mbështesë këtë vit, një nga 10 sportistet më të mira të botës në 3 vitet e fundit dhe shqiptarja që mbajti flamurin tonë në Lojërat Olimpike Europiane Baku 2015, ku shkëlqeu me dy medalje (të artë dhe të argjendtë). Ajo është 28-vjeçarja Luiza Gega, mbajtëse e 7 rekordeve kombëtare në disiplinat 800m-1500m si dhe mbajtëse e rekordit të Lojërave Olimpike Europiane në disiplinën 1500m.

Kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, në kuadër të përgjegjësisë sociale dhe mbështetjes që i ka dhënë ndër vite sportit dhe që vazhdon të japë, do të mbështesë financiarisht talenten Gega, duke dhënë kështu shembullin e shkëlqyer për mbështetje të talenteve shqiptare që përfaqësojnë Shqipërinë në arenat ndërkombëtare dhe jo vetëm.

Kontrata për mbështetjen e Luiza Gegës, u firmos nga Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, z. Avni Ponari dhe nga vetë atletja Gega, e cila i shprehu falënderimet e përzemërta zotit Ponari, duke veçuar se SIGAL UNIQA është e para kompani sigurimesh që ka ofruar mbështetje financiare për të.

Ndërsa, zoti Ponari tha se ishte i kënaqur që po mbështet një talente si Luiza Gega, e cila na ka përfaqësuar denjësisht në kompeticionet ndërkombëtare dhe se SIGAL UNIQA do të vazhdojë të kontribuojë në përmirësimin e sportit në Shqipëri e Kosovë si dhe në mbështetjen e talenteve shqiptarë.

Luiza Gega është e vetmja athlete shqiptare që përfaqëson Shqipërinë në garat “Diamond League dhe World Challenge” prej më shumë se 3 vjetesh. Ajo ka marrë 12 medalje të arta në “European League III”, ku Shqipëria merr pjesë, është shpallur 8 herë Kampione e Ballkanit, në disiplinat 800m, 1500m dhe 3000m/p, si dhe ka triumfuar 25 herë me medalje të arta në mitingje ndërkombëtare. Sportistja e parë shqiptare që ka arritur Normën Olimpike për të përfaqësuar Shqipërinë në Rio2016, numëron me dhjetëra kompeticionë kombëtare e ndërkombëtare si dhe dhjetëra medalje ari dhe argjendi në athletikë.

Përveç përgjegjësisë kontraktuale me klientët, të realizuar nëpërmjet dëmshpërblimeve në kohë, SIGAL UNIQA i ka kushtuar një rëndësi të veçantë edhe përgjegjësisë sociale, duke kontribuar në projekte sociale, kulturore, sportive si dhe në arsim e edukim. Krahas mbështejes dhe ndihmesës 17-vjeçare që nga koha e themelimit të saj, vetëm gjatë vitit 2015 SIGAL UNIQA ka mbështetur:

Festivalin Ndërkombëtar të Gjirokastrës; Festivalin Ndërkombëtar të Vokalit Operistik “Marie Kraja”; Publikimin e librit të At Zef Pllumit ‘Rrno për me tregue’ e shumë aktivitete të tjera.

Që prej disa muajsh Liga Ballkanike e Basketbollit është riemërtuar “SIGAL UNIQA Balkan League”, emër të cilin do ta mbajë për një periudhë 3-vjeçare. Skuadra kampione në Ligën Ballkanike “SIGAL Prishtina” gjithashtu mbështetet nga SIGAL UNIQA.

Në kuadër të kësaj përgjegjësie sociale, SIGAL UNIQA u nominua nga Qeveria Shqiptare në eventin gala të sipërmarrësve më të mirë të vitit, “Bleta e Artë 2015”, për çmimin “Sipërmarrje në Kulturë”, si një ndër katër kompanitë më të mira që ka mbështetur artin dhe kulturën në vend.

SIGAL UNIQA, përgjatë 2015-ës, ka ardhur me risi të reja për publikun:

Ndërtoi të vetmen klinikë lëvizëse në rajon, e cila do të ofrojë ekzaminime falas në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni; Inicioi portalin informativ www.albaniainsurance.com, synimi i të cilit është ofrimi i informacioneve për zhvillimet në tregun e sigurimeve në rajon; Ka ndërtuar një aplikacion për Iphone dhe Android, i cili përmban informacion për produkte si dhe mundësinë për ti kërkuar/blerë ato direkt online); Për herë të parë në vend, SIGAL UNIQA organizoi një takim informativ me gazetarët për të diskutuar mbi problematikat e tregut shqiptar të sigurimeve dhe rolin e medias në të; SIGAL UNIQA ka krijuar një ‘produkt’ novator komunikimi: “UNIQ’Art”, ku paraqitet domosdoshmëria e sigurimeve në një këndvështrim artistik, nëpërmjet karikaturave të Mjeshtrit të Madh, Bujar Kapexhiu.

Në kuadër të promovimit të Shqipërisë, me ftesë të UNIQA dhe SIGAL UNIQA, Grupi Rotarian Austriak, në përbërjen e të cilit janë biznesmenët më të mëdhenj të Austrisë, vizitoi për herë të parë Shqipërinë, gjatë vitit 2015.

Të bindur se mbështetja për Shqipërinë dhe vlerat që mbart është investimi më i mirë që mund të bëjmë, 2016-ën e kemi nisur me ide dhe projekte të reja.

**Drejtoria e Përgjithshme**

Qendra e Biznesit SIGAL

Blv. Zog I , Nr 1,Tirana – Albania

Phone: +355 4 2233308

Fax: +355 4 2250220

E-mail: info@sigal.com.al

## Intervistë me Drejtorin e Përgjithshëm të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, z. Avni Ponari

***Gazetarja:*** **Tashmë jemi sërish në një situatë jo të favorshme përsa i përket bujqësisë dhe blegtorisë për shkak të përmbytjeve. Vetë ministri i Bujqësisë, dy ditë më parë rekomandoi sigurimin e bujqësisë që fermerët dhe blegtorët të vetësigurohen, por bëri më dije se ka iniciuar edhe një projekt pilot që sigurimi për fermerët të bëhet i detyrueshëm, si për tokat bujqësore ashtu edhe për ata që kanë ndërtuar biznese në tokat e tyre, pra bëhet fjalë për investime në blegtori apo bujqësi. Ju si siguruesi kryesor dhe më i madh i gjithë Shqipërisë, si mendoni, nëse fermerët do të kenë mundësi të sigurohen a përballohet kjo nga ana financiare?**

***Ponari:*** Për situatën klimaterike që po kalon sot jo vetëm vendi ynë por e gjithë Europa dhe gjithë bota, dy janë rreziqet kryesore që kanosen herë pas here: përmbytjet dhe tërmetet. Çfarë po ndodh aktualisht në Shqipëri? Të paktën 10-15 vitet e fundit kemi parë ngjarje me efekte shumë të mëdha financiare, siç janë përmbytjet, rrëshqitjet e tokave, shembjet e urave etj, të cilat vijnë si pasojë e shumë faktorëve që kanë ndikuar në prishjen e ekuilibrave ekologjikë në vend. Sigurimet janë një industri, e cila përpiqet që të rikthejë në gjendjen e mëparshme një dëm të ndodhur, por natyrisht që ato nuk janë shpëtimtare të gjithë kësaj situate të krijuar. Sigurimet janë një ndër tri shtyllat e zhvillimit të ekonomisë së një vendi, dhe duke qenë kaq të fuqishme dhe kaq të rëndësishme ato kanë një rol kyç në këtë fushë. Ka shumë vite që në Shqipëri përpiqen për të ndërtuar një ligj, i cili ka qenë iniciuar edhe nga Banka Botërore, një ligj për sigurimin nga katastrofat, ku përfshihen përmbytjet dhe tërmetet. Sa është punuar me këtë ligj dhe si është ecur deri më sot? Fakti që ai ligj nuk është egzistent, tregon që ka mbetur thjeshtë në kuadrin e bisedave dhe takimeve, por nuk është bërë asgjë konkrete. Për pasojë, sa kohë që nuk kemi asgjë të rregulluar me ligj, edhe pëmbytjet dhe zonat rurale janë nën efektin e këtij risku të përditshëm, dhe sa herë bie shi i lutemi Zotit ishalla nuk përmbytemi.

Mundësitë janë të gjithanshme. Industria e sigurimeve ka qenë pjesë e takime dhe ka kërkuar me këmbëngulje që ligji për sigurimin e bujqësisë dhe blegtorisë të bëhej i mundur, dhe natyrisht që kemi qenë në negociata edhe me tregjet ndërkombëtare, sepse është e pamundur që një industri në një vend të vogël siç është Shqipëria të ketë kapacitete që të mbulojë 100% katastrofat natyrore. Por e vërteta është që ne i kemi gjetur këto kapacitete në tregjet e huaja ndërkombëtare, sepse kështu funksionon edhe industria e sigurimeve.

Ndërtimi i këtij ligji është i rëndësishëm, sepse në fund të fundit kontributi i të gjithë aktorëve, i gjithë fermerëve dhe blegtorëve në të gjithë Shqipërinë do të kontribuojë në krijimin e një fondi, i cili edhe në bazë të përvojës të të gjithë Europës Qendrore dhe asaj Lindore, do të shërbejë për të krijuar një fond për tu mbrojtur nga rreziqet natyrore, siç janë përmbytjet dhe tërmetet, rrezique të cilat shfaqen herë pas here, janë të mëdha dhe të papërballueshme nga familjarët.

Qeveria Shqiptare është përpjekur me të gjitha format dhe të gjitha mënyrat për të krijuar mundësinë dhe nganjëherë edhe është përdorur më shumë si një fushatë elektorale sesa për tu zgjidhur problemet e këtyre banorëve, sepse zgjidhja e problemit është transferimi i dëmeve që ata pësojnë tek një palë tjetër, që në këtë rast është industria e sigurimeve.

Moszgjidhja e këtij problemi madhor bën që ai të shfaqet herë pas here, dhe qeveria përpiqet me mënyrat e veta për ta zgjidhur, duke prekur edhe buxhetin e shtetit dhe taksat e qytetarëve, taksa të cilat në vend që të shkojnë për investime në fusha të tjera dhe në të mira publike shkojnë për mbulimin e këtyre rreziqeve.

Mundësitë janë të mëdha. Natyrisht kur ka një ide të qartë, kur ka një ligj dhe kur njerëzit kërkojnë që ky ligj të jetë ekzistent dhe t'ju shërbejë atyre, atëherë edhe përpjekjet janë të gjithanshme. Aktualisht tregu i sigurimeve është i gatshëm për të mbuluar këto rreziqe, pasi ka një përvojë shumë vjeçare në ofrimin e këtyre produkteve. Por e vërteta është që ka pak persona të siguruar në këtë sektor, pasi njerëzit kujtohen për përmbytjet kur bie shi dhe atëherë kuptojnë edhe domosdoshmërinë e sigurimeve, dhe thonë po sikur të isha siguruar, ndërkohë që në kohë me diell nuk kujtohen për rreziqet që mund tu shkaktohen.

Një nga masat më të mira do të ishte që shteti të ndërtojë një ligj, ashtu siç ka ndodhur në Turqi, në Greqi, në Rumani, në Poloni dhe pothuaj në të gjithë Europën, që tu shërbejë qytetarëve për tu mbuluar nga katastrofat natyre dhe rreziqet e kësaj natyre. Qeveria duhet të heqë dorë nga e drejta që ka për të shkuar në zonat e përmbytyra dhe të kalojë në krahun tjetër, ku ti kërkojë industrisë së sigurimeve pagesat e menjëhershme për dëmet e ndodhura në rast të përmbytjeve.

Kapacitetet janë të gjitha, produktet për sigurimin e kësaj kategorie janë, është çdo gjë e nevojshme për klientët por nuk ekziston dëshira e atyre që duhet të sigurohen dhe nuk ekziston dëshira për të krijuar një ligj për të ndërtuar një mbrojtje kolektive të gjithanshme në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Format janë të ndryshme. Mund të jetë një ligj i detyrueshëm siç e ka bërë Turqia dhe Rumania kohët e fundit për mbrojten nga katastrofat, dhe tanimë kanë krijuar rezervat e bollshme për të përballuar këto rreziqe. Turqia është vend i madh dhe mund të ketë rezerva mbi 10 miliardë Euro, edhe Rumania mund të ketë rezerva të ngjashme, ndërsa vendet e vogla kanë blerë rreziqet në tregjet e risigurimeve në kompani të mëdha, siç është Munich Re, Swiss Re apo Hannover Re, apo disa nga kompanitë më me emër në botë, të cilat mund ta ofrojnë këtë mundësi duke patur kapacitete të mëdha financiarë për të mbuluar këto rreziqe në rajone të ndryshme të vendit.

Atij numri të vogël klientësh të siguruar, natyrisht që ne iu përgjigjemi në kohë, natyrisht që ato përfitojnë sepse kanë një kontratë sigurimi të cilën ne e respektojmë, por totali i tyre është vetëm 550 persona të siguruar për përmbytjet, duke llogaritur që SIGAL UNIQA është kompania më e madhe dhe që ka më shumë klientë.

***Gazetarja:* Në lidhje me skemat e sigurimeve, mendoni se do të ishte më mirë që të mbulohen vetëm nga kompanitë e sigurimeve, apo të ketë një bashkëpunim dhe ndërthurje edhe me buxhetin e shtetit apo qoftë edhe me banka të nivelit të dytë?**

**Ponari:** Njerëzit mendojnë që kostot e sigurimit nga përmbytjet duhet të jetë shumë të mëdha. Në fakt kostoja është e vogël. Është një kosto e përballueshme dhe e bashkuar edhe me përgjegjësinë për dëmet që mund tu shkaktohet palëve të treta shkon në një mesatare shumë të ulët. Për shembull, në zonat e vogla mund të shkojë në 15 Euro totali në vit, ndërsa në zona si Tirana mund të shkojë në 1

Euro/m2. Pra totali i pagesave që mund të paguhet për këtë lloj sigurimi dhe për të krijuar një mbrojtje nga ky rrezik është një vlerë shumë e vogël. Ne konsiderojmë rreth 1 milionë banesa dhe biznese dhe totali i primeve që mund të mblidhen shkon rreth 25-30 milionë Euro, të cilat shkojnë për blerjen e rreziqeve, pasi duhet të krijohet një shtresë prej minimalisht 300 milionë Eurosh. Ky është kapaciteti i duhur dhe i mundshëm në një vit në Shqipëri. Por duke realizuar këtë këtë lloj sigurimi dhe duke pasur një rezervë minimale, shteti mund të ndërhyjë për shtresat që janë në nevojë, që mund të jetë një vlerë 2-3 milionë Euro, ndërsa pjesa tjetër le të paguhet nga qytetarët, nga bizneset, nga ato që i kanë mundësitë për ti paguar, duke krijuar kështu një garanci për dëmet që mund t'u shkaktohen. Në këtë mënyrë qytetarët do të kenë një marrëdhënie me industrinë private të sigurimeve dhe shteti duhet të jetë një albitër shumë i fortë dhe detyrues për tregun e sigurimeve, që në rast se realizohet ky lloj sigurimi, siguruesit duhet tu përgjigjen menjëherë qytetarëve në rast të dëmeve në kohën e duhur. Afatet e dëmshpërblimeve janë të përcaktuar qartë dhe janë shumë të shkurtra dhe qytetarët s'kanë pse të presin me vite për tu dëmshpërblyer. Për shembull kur është përmbytur Praga 5 vjet përpara, janë paguar 1 miliardë Euro nga tregu i sigurimeve brenda një harku kohor prej 10 ditësh, për të pastruar dhe rikthyer Pragën në gjendjen e mëparshme pas vërshimit të lumenjve.

Duhet të kthehemi tek përgjegjësia individuale, që secili të ndjejë përgjegjësi për atë që ka dhe të heqë dorë nga kërkesa duke iu drejtuar shtetit, sepse ky është një mentalitet i vjetur i ngulitur keq, dhe njerëzit vazhdojnë që për çdo problem që kanë ti drejtohen shtetit, bashkive, apo institucioneve shtetërore, kur në fakt duhet ti drejtohen vetes dhe tregut të sigurimeve, sepse ai është shpëtimtari, ashtu siç ndodh edhe në të gjithë botën. Në asnjë vend të botës qytetarët nuk u drejtohen zyrave të institucioneve shtetërore, por u drejtohen kompanive të sigurimit, për dëmet që kanë në autostrada, për dëmet që kanë në miniera, për dëmet që kanë në shtëpi, për fatkeqësi natyrore etj, pra për çdo lloj dëmi janë kompanitë e sigurimeve ato që dëmshpërblejnë qytetarët.

Ndaj edhe në Shqipëri duhet të futet kjo kulturë dhe ky ligj. Kompanitë e sigurimeve i kanë të gjitha kapacitetet për të mbuluar çdo lloj dëmi që mund të ndodhë, dhe në treg operojnë kompani me përvojë europiane, që operojnë me të njëjtat standarte, me të njëjtat kapacitete dhe cilësi si në vendet e Europës. Qytetarët duhet t'u drejtohen këtyre kompanive, të ndërtojnë marrëdhëniet me to dhe të shkëpusin vëmendjen nga shteti, sepse shteti ka plot gjëra të tjera për të zgjidhur dhe le të bëjë ato që i takojnë të bëjë.

**Gazetare, Amela Zhabjaku, TVSH**

**Datë, 13.01.2016**

UNIQA > Njoftime per shtyp > Tiranë më, 30.12.2015

# Tiranë më, 30.12.2015

**SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA**

**Analiza vjetore, SIGAL UNIQA vazhdon të udhëheqë tregun e sigurimeve**

Kompania më e madhe e sigurimeve në vend, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, mbylli një vit të suksesshëm të punës së saj në Shqipëri dhe rajon. Grupi SIGAL UNIQA, me 7 kompani sigurimi jetë dhe jo-jetë dhe një Fond Pensionesh Private, në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni kryeson tregun rajonal të sigurimeve. 2015 ishte një vit mjaft i mirë për të gjitha kompanitë e SIGAL UNIQA, të cilat shënuan një rritje në total prej 14% më shumë krahasuar me një vit më parë. Referuar të dhënave të Autoriteteve Financiare, kompanitë SIGAL UNIQA udhëhoqën sërish tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe Kosovë si dhe kanë përforcuar ndjeshëm pozitat në Maqedoni.

Rreth 1 milionë klientë kanë besuar sigurimin e jetës, shëndetit, makinës, shtëpisë, pasurisë dhe të çdo aseti tjetër me vlerë tek SIGAL UNIQA, kjo falë korrektësisë që kjo kompani tregon ndaj klientëve të saj. Vetëm për vitin 2015, SIGAL UNIQA ka dëmshpërblyer në një vlerë totale klientët e saj prej rreth 18 milionë Euro.

Në fjalën e tij gjatë takimit vjetor, Drejtori i Përgjithshëm, z. Avni Ponari u shpreh i kënaqur me rezultatet e grupit, me punën shumë të mirë të rreth 1200 punonjësve dhe agjentëve dhe mbi të gjitha falënderoi klientët për besimin e dhënë ndër vite. Më tej, z. Ponari tha se kjo rritje shumë e kënaqshme e grupit, pa dyshim që nga prapa ka një partner gjigand në fushën e sigurimeve, i cili është “UNIQA Insurance Group”.

UNIQA GROUP është lider në tregun e sigurimeve të Austrisë dhe të Europës Qendrore dhe asaj Lindore. Mbi 14 mijë punonjës iu shërbejnë 10 milionë klientëve në 19 shtete, nga të cilat 15 shtete të Europës Qendrore-Lindore. Gjigandi austriak i sigurimeve, me një histori 150-vjeçare në tregun e sigurimeve, zotëron mbi 3 miliardë Euro kapitale.

Përveç përgjegjësisë kontraktuale me klientët, të realizuar nëpërmjet dëmshpërblimeve në kohë, SIGAL UNIQA në vitin 2015 i ka kushtuar një rëndësi të veçantë edhe përgjegjësisë sociale. Krahas aktiviteteve të përjavshme artistike në Klubin e Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA në Durrës, gjatë vitit 2015 SIGAL UNIQA ka mbështetur:

Festivalin Ndërkombëtar të Gjirokastrës; Festivali Ndërkombëtar i Vokalit Operistik “Marie Kraja”; Publikimi i librit të At Zef Pllumit ‘Rrno për me tregue’ e shumë aktivitete të tjera.

Që prej disa muajsh Liga Ballkanike e Basketbollit është riemërtuar “SIGAL UNIQA Balkan League”, emër të cilin do ta mbajë për një periudhë 3-vjeçare.

Në kuadër të kësaj përgjegjësie sociale, SIGAL UNIQA u nominua nga Qeveria Shqiptare në eventin gala të sipërmarrësve më të mirë të vitit, “Bleta e Artë 2015”, për çmimin “Sipërmarrje në Kulturë”, si një ndër katër kompanitë më të mira që ka mbështetur artin dhe kulturën në vend.

SIGAL UNIQA, përgjatë 2015-ës, ka ardhur me risi të reja për publikun:

Ndërtoi të vetmen klinikë lëvizëse në rajon, e cila do të ofrojë ekzaminime falas në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni; Inicioi portalin informativ www.albaniainsurance.com, synimi i të cilit është ofrimi i informacioneve për zhvillimet në tregun e sigurimeve në rajon; Ka ndërtuar një aplikacion për Iphone dhe Android, i cili përmban informacion për produkte si dhe mundësinë për ti kërkuar/blerë ato direkt online); Në bashkëpunim me shtypin e shkruar, SIGAL UNIQA ka publikuar që prej disa muajsh suplemente 4-faqëshe ‘SIGAL UNIQA Info’, të cilët ofrojnë informacion për tregun dhe produktet e sigurimit. Gjithashut, për herë të parë në vend, SIGAL UNIQA organizoi një takim informativ me gazetarët për të diskutuar mbi problematikat e tregut shqiptar të sigurimeve dhe rolin e medias në të; SIGAL UNIQA ka krijuar një ‘produkt’ novator komunikimi: “UNIQ’Art”, ku paraqitet domosdoshmëria e sigurimeve në një këndvështrim artistik, nëpërmjet karikaturave të Mjeshtrit të Madh, Bujar Kapexhiu.

Në kuadër të promovimit të Shqipërisë, me ftesë të UNIQA dhe SIGAL UNIQA, Grupi Rotarian Austriak, në përbërjen e të cilit janë biznesmenët më të mëdhenj të Austrisë, vizitoi për herë të parë Shqipërinë, gjatë vitit 2015.

Të bindur se mbështetja për Shqipërinë dhe vlerat që mbart është investimi më i mirë që mund të bëjmë, mirëpresim 2016-ën me ide dhe projekte të reja.

**Drejtoria e Përgjithshme**

Qendra e Biznesit SIGAL

Blv. Zog I , Nr 1

Tirana – Albania

Phone: +355 4 2233308

Fax: +355 4 2250220

E-mail: info@sigal.com.al

Website: www.sigal.com.al

## 07/11/2015

**Klinika Lëvizëse Mjekësore SIGAL UNIQA** është një risi për shërbimin shëndetësor në Shqipëri, do të ofrojë ekzaminime shëndetësore falas për të gjithë banorët e kësaj zone.

Me një staf mjekësor profesionional, në klinikën lëvizëse të SIGAL UNIQA mundësohen një shumëllojshëmri ekzaminimesh, duke filluar nga vizita dhe konsulta me mjekun patolog, matje e sheqerit në gjak, vizitë sysh e ORL deri tek imazheritë të tilla si Elektrokardiograma e zemrës, Echo abdominale, Echo e indeve të buta, Echo e artikulacioneve, matje e kapacitetit vital të mushkërive, matje e oksigjenit në gjak me spirometër etj.

Klinika lëvizëse SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA është e para dhe e vetmja klinikë e këtij lloji në Shqipëri. Duke mundësuar ekzaminime të ndryshme mjekësore në të gjithë vendin, përfshirë zonat rurale, SIGAL UNIQA synon promovimin e shëndetit të mirë duke nxitur njerëzit për kontrolle shëndetësore rutinë nëpërmjet të cilave diagostikohen sëmundje të ndryshme, trajtimi i të cilave është më i lehtë nëse kurohen në kohën e duhur.

Nën moton "MENDO, shëndeti vjen i pari", SIGAL UNIQA që prej vitit 2007 ka prezantuar për publikun sigurimin shëndetësor familjar, përmes të cilit mbulohen faturat mjekësore në klinka dhe spitale thuajse në të gjithë botën. Aktualisht, mbi 10.000 invidivë dhe familje në mbarë Shqipërinë kanë zgjedhur të sigurojnë shëndetin tek SIGAL UNIQA. Vetëm në 9-mujorin e parë të këtij viti, SIGAL UNIQA ka paguar mbi 195 milonë lekë për mbulimin e shpenzimeve mjekësore të këtyre klientëve, duke iu mundësuar në këtë mënyrë marrjen e një shërbimi shëndetësor cilësor si jashtë ashtu edhe brenda vendit.

## Tiranë më, 28.10.2015

### SIGAL UNIQA takim informues me gazetarët dhe përfaqësuesë të medias

***Kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri zhvilloi një takim informues me përfaqësuesë të medias për të folur mbi zhvillimin dhe sfidat e tregut të sigurimeve në vend si dhe nevojën e një mediaje të informuar. Ky është i pari takim i këtij lloji nga një kompani sigurimesh.***

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA zhvilloi dje një takim me përfaqësuesë të medias në vend dhe figura publike aktive në media, për të folur për tregun e sigurimeve në Shqipëri, sfidat dhe potencialet e zhvillimit të këtij tregu.

Është hera e parë që në Shqipëri zhvillohet një takim i tillë, ku të pranishëm ishin gazetarë, moderatorë dhe përfaqësuesë nga të gjitha mediat audio-vizive dhe asaj të printuar.

Drejtori i Përgjithshëm i Sigal Uniqa Group AUSTRIA, kompanisë më të madhe të sigurimeve në Shqipëri, Avni Ponari, përgjatë bashkëbisedimit me gazetarët, vuri theksin tek nevoja e një mediaje të informuar për tregun e sigurimeve, gjithashtu domosdoshmërinë që media duhet të luajë për informimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve për t'u siguruar, pasi sigurimet tha Ponari janë një domosdoshmëri dhe jo luks.

Duke bërë një analizë të tregut të sigurimeve në Shqipëri dhe rajon, Ponari tha se "Shqipëria renditet e fundit në rajon për sigurimet, me vetëm 16 Euro për frymë, ndërkohë që nëse krahasohemi me vendet e tjera shifrat arrijnë në qindra Euro për vendet fqinje, ndërsa në vendet e BE-së qytetarët paguajnë një mesatare prej 2154 eurosh për frymë, pa harruar Zvicrën e cila kap edhe shifrën më të lartë: 2675 Euro për person. Nisur nga shifrat e mësipërme, rrjedhimisht edhe pesha që ka industria e sigurimeve në GDP është tepër e vogël. Në Shqipëri të ardhurat nga sigurimet zënë vetëm 0.6% të GDP-së, kur në të njëjtën kohë fqinji ynë Italia ka një volum primesh të sigurimeve që zënë 8.1% të GDP-së".

Në takim u fol edhe mbi faktin se si mund të ndryshohet trendi i sigurimeve, pasi aktualisht në Shqipëri kemi një treg sigurimesh ku 60% e të cilit përbëhet nga shitja e sigurimeve të detyrueshme të makinave, duke lënë në plan të dytë rëndësinë e sigurimit të jetës, shëndetit, pasurisë, biznesit etj. Problematike mbetet fakti që sigurimet vullnetare janë shumë pak të zhvilluara, nga ana tjetër një pjesë e mirë e sigurimeve të detyruara me ligj, siç janë sigurimet e ndërtuesve, sigurimet në miniera, sigurimet e pikave të karburanteve, të përgjegjësive ndaj palëve të treta etj, nuk gjejnë zbatim në plotë.

Drejtori i SIGAL UNIQA, Ponari, tha se sigurimi nga katastrofat natyrore duhet të jetë i detyrueshëm, veçanërisht për zonat me rrezik të lartë, dhe nuk la pa theksuar tregun e pensioneve private, i cili duhet të zhvillohet përmes miratimit të reformës për skemën e pensioneve, ku një pjesë e kontributeve që qytetarët derdhin për pension shteti të administrohet nga shoqëritë private të sigurimeve.

Në fund drejtuesit e SIGAL UNIQA iu përgjigjën edhe pyetjeve specifike të secilit pjesëmarrës, të cilët thanë se takime të tilla janë tepër frytdhënës dhe se duhet të realizohen më shpesh.

## Tiranë më, 14.10.2015

**Njoftim për mediat**

**BIBL nënshkruan marrëveshje 3-vjeçare me SIGAL UNIQA Group Austria**

***Liga Ballkanike e Basketbollit (BIBL) që nga tetori i këtij viti do të quhet "SIGAL UNIQA Balkan League". Marrëveshja u firmos nga CEO i SIGAL UNIQA për Shqipërinë, Kosovën dhe Maqedoninë, njëherësh edhe President i Federatës Shqiptare të Basketbollit, z. Avni Ponari dhe nga Drejtori i BIBL, z.* Shay Shtriks.**

Liga Ballkanike e Basketbollit (BIBL) tashmë do të quhet "SIGAL UNIQA Balkan League". Duke filluar që nga sezoni i ri 2015-2016 BIBL do të ketë emërtimin e ri, falë marrëveshjes 3-vjeçare që u arrit me SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, pjesë e grupit më të madh të sigurimeve në Austri "UNIQA Insurance Group", e përfaqësuar në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni nga z. Avni Ponari, nëpërmjet 8 kompanive jetë dhe jo-jetë SIGAL UNIQA.

"UNIQA Insurance Group" është një nga kompanitë lider të sigurimit në tregun Austriak dhe atë të Europës Lindore dhe Qendrore. Me një eksperiencë 150-vjeçare, me rreth 40 kompani në 19 shtete, UNIQA u shërben më shumë se 10 milionë klientëve nëpërmjet 22 mijë punonjësve të saj. UNIQA dhe Raiffeisen Versicherung janë dy kompanitë më të fuqishme të sigurimeve në Austri dhe të mirëpozicionuara në tregun e Europës Lindore dhe Qendrore.

UNIQA është prezente në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni që prej vitit 2007 përmes kompanisë më të madhe të sigurimeve SIGAL UNIQA, duke zotëruar 68.64% të aksioneve të saj. Që prej vitit 2002, SIGAL UNIQA kryeson tregun shqiptar të sigurimeve duke zotëruar mesatarisht 35% të tregut të sigurimeve jetë, jo-jetë dhe pensioneve private.

"BIBL, tashmë 'SIGAL UNIQA Balkan League', është krenare që një kompani me një reputacion të tillë si SIGAL UNIQA Group pranoi që të bashkëpunonte me projektin tonë për Ballkanin dhe të na jepte mundësinë që të kemi emrin e tyre për tre vitet e ardhshme. Kjo tregon që edhe pse Ballkan League është e pranishme vetëm në Ballkan, falë një organizimi të mirë të zhvillimit të sporteve me benefite për komunitetet lokale, ne fituam besimin e një emri tepër të njohur siç është SIGAL UNIQA Group AUSTRIA", -thuhet në njoftimin për shtyp të SIGAL UNIQA Balkan League.

Ndër të tjera, në njoftimin zyrtar të Ligës Ballkanike të Basketbollit nënvizohet edhe mbështetja e pakufizueshme e z. Avni Ponari.

“Personi kyç që qëndron pas gjithë kësaj, me një mbështetje të madhe dhe me besim tek ne, është zoti Avni Ponari, CEO i SIGAL UNIQA. Si President i Federatës Shqiptare të Basketbollit, zoti Ponari është një mik i madh dhe një mbështetës i basketbollit. Ai ka punuar shumë që të promovojë basketbollin jo vetëm në Shqipëri dhe Kosovë, ku SIGAL UNIQA kryeson tregun e sigurimeve, por në të gjithë rajonin e Ballkanit. Tani, me detyrën e re si pjesë e Ligës Ballkanike të Basketbollit, zoti Ponari shton një arritje më shumë në paketën e tij të mirënjohjeve, së bashku me çmimet dhe vlerësimet e shumta që ai merr në vendin e tij, në Shqipëri, si dhe në të gjithë Europën. Ai është gjithashtu anëtar i Komisionit të Financës të FIBA Europe”.

Mbështetja e z. Ponari për sportet në përgjithësi dhe për basketbollin në veçanti është reflektuar në ndihmesën që ai ka dhënë për disa skuadra basketbolli, ndërmjet të cilave edhe SIGAL Prishtina dhe klubin e basketbollit Vllaznia. Ponari ka qenë iniciator i aktivitetit të “StreetBall Albania” i kthyer tashmë në traditë në Shqipëri. Në kuadër të anxitjes së të rinjve për tu angazhuar me sporte, z. Ponari këtë vit nënshkroi edhe një marrëveshje me Ministrinë e Arsimit, për zhvillimin e basketbollit në çdo shkollë të mesme të vendit.

**Drejtoria e Përgjithshme**

Qendra e Biznesit SIGAL

Blv. Zog I , Nr 1

Tirana – Albania

**Zyra e Marrëdhënieve me Publikun**

Phone: +355 4 2233308

Fax: +355 4 2250220

E-mail: info@sigal.com.al

Website: www.sigal.com.al

## SIGAL UNIQA dhe Porsche Bank zgjerojnë bashkëpunimin rajonal

*U firmos në Tiranë marrëveshja për partneritet preferencial mes grupit rajonal SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni) dhe Porsche Bank.*



Në marrëveshjen e firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Z. Avni Ponari dhe Drejtori i Përgjithshëm i Porsche Finance Group Serbia Z. Dejan Pavlovic, garantohet asistenca e plotë e SIGAL UNIQA në shitjen dhe sigurimin e automjeteve përmes Porsche Leasing tashmë edhe në Maqedoni.

Në sajë të eksperiencës së gjatë që të dyja kompanitë kanë si dhe ekspertizës ndërkombëtare, ky bashkëpunim do të mundësojë financimin e blerjes dhe sigurimit të automjeteve të një njëjtin nivel me standardet europiane.

Në fjalën e tij, Z. Ponari shprehu kënaqësinë që bashkëpunimi i suksesshëm mes SIGAL UNIQA dhe Porsche u shtri edhe ne Maqedoni si dhe bindjen se partneriteti do të jetë njësoj frytdhënës në Maqedoni sikurse është në Shqipëri që prej disa vjetësh.

Vendosja e partneriteteve preferenciale është pjesë e strategjisë që UNIQA Insurance Group ndjek në të gjitha vendet ku operon si një mundësi e mirë për të ofruar shërbim edhe më cilësor tek rreth 17 Milionë klientët e saj. Grupi i fuqishëm financiar europian UNIQA Insurance Group është prezent në rajon përmes kompanive 8 SIGAL UNIQA në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.




Që prej vitit 2002, SIGAL kryeson tregun shqiptar të sigurimeve duke zotëruar mesatarisht 35% të tregut të sigurimeve jetë, jo-jetë dhe pensioneve private.

Gjithashtu, kompania renditet e para edhe përsa i përket pagesës së dëmeve duke paguar mesatarish 30% të dëmeve totale të tregut të sigurimeve në vend.

Me një përvojë të gjatë në fushën e sigurimeve, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA kryeson tregun edhe për sigurimet KASKO të automjeteve. Sipas raportit të Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare për periudhën Janar-Gusht 2015, totali i primeve nga sigurimet KASKO arriti në 386 Milionë Lekë dhe SIGAL UNIQA zotëroi 33% të këtij tregu. Kompanitë e sigurimit kanë paguar në total 200 Milionë lekë dëmë për automjetet e pajisuara me policën KASKO nga të cilat rreth 28% janë mbuluar nga SIGAL UNIQA.

Ndërkohë, për 9 mujorin e këtij vitit, SIGAL UNIQA ka paguar dëme KASKO në vlerën totale prej 56 Milionë lekë.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në adresën e mëposhtme:

**Drejtoria e Përgjithshme**

Qendra e Biznesit SIGAL

Blv. Zog I , Nr 1

Tirana - Albania

Phone: +355 4 2233308

Fax: +355 4 2250220

E-mail: info@sigal.com.al

Website: www.sigal.com.al

UNIQA > Njoftime per shtyp > njoftim_29_09_2015.php

**Qeveria e Japonisë akordon 'Certifikatën e Mirënjohjes' për Z. Avni Ponari, Konsulli i Përgjithshëm Nderit i Japonisë në Shqipëri**



Ambasadori i Japonisë, SH.T.Z.. Kazuyoshi Umemoto i ka dorëzuar Z. Avni Ponari 'Çertifikatën e Mirënjohjes' të Ministrisë së Jashtme Japoneze. Certifikata, e cila iu dorëzua Z. Ponari gjatë një ceremonie në praninë e ZëvendësKryeministrit Niko Peleshi, u akordua më motivacionin 'Për kontribute të mëdha në forcimin e marrëdhënieve midis Japonisë dhe Shqipërisë'. Në certifikatën e firmosur nga Ministri i Jashtëm Japonez Fumio Kishida shprehet mirënjohja e thellë e qeverisë japoneze për arritjet e veçanta të Z. Ponari gjatë dy mandateve të tij si Konsull i Përgjithshëm Nderi i Japonisë në Shqipëri.

"Certifikata e Mirënjohjes" është një prej vlerësimeve që Qeveria Japoneze u jep titullarëve që promovojnë Japoninë në të gjitha aspektet e saj dhe për herë të parë në Shqipëri i jepet Z. Avni Ponari.



I emëruar Konsull i Përgjithshëm Nderi i Japonisë në Shqipëri që prej vitit 2009, Z. Ponari hyri në mandatin e tij të dytë disa muaj më parë pas miratimit të Ministrive të Jashtme të të dy vendeve. Përgjatë këtyre viteve, një seri projektesh të qeverisë japoneze janë zbatuar në Shqipëri kryesisht në fushën e edukimit dhe shëndetësisë të cilat kapin vlerën e miliona euro. Ndër to vlen të përmendet investimi më i fundit ishte i pak ditëvë më parë me shkëmbimin e notave mes dy qeverive për automjetet ekologjike për institucionet shqiptare me vlerë 3.7 Milionë Euro.

Për publikun Z. Ponari është një prej biznesmenëve më të suksesshëm, gjerësisht i njohur në pozicionin e tij si Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, shoqërisë më të madhe të sigurimeve në vend, një kompani të cilën e ka themeluar në vitin 1999. Krahas angazhimit të tij në fushën e sigurimeve, Z. Ponari ka luajtur një rol të madh në zhvillimin ekonomik në Shqipëri pasi ai menaxhon dhe zotëron edhe kompani të tjera të cilat operojnë suksesshëm në Shqipëri dhe rajon si dhe është anëtar bordi i insitucioneve të rëndësishme financiare në vend.

Vlerësimet dërkombëtare për arritjet dhe kontributin në fusha të ndryshme i janë akorduar edhe më parë Z. Ponari ndër të cilat vlejnë për tu përmendur tituj si: Njeriu i Vitit, International Who’s Who, American Biographical Institute, Profili Ndërkombëtar i Drejtuesve më të Mirë dhe Lideri i Vitit.

UNIQA > Njoftime per shtyp > njoftim_09_06_2015.php

**UNIQA INSURANCE GROUP: 2 Miliardë Euro prime në tremujorin e parë 2015**

Kompania austriake e cila operon edhe në Shqipëri, rritet më 20%

Ne raportin e 3-mujorit te pare të 2015 te publikuar keto dite të gjigandit europian të sigurimeve, UNIQA Insurance Group, flitet per nje rritje te volumit te primeve prej 19.8% duke arritur vleren prej 2,039 Milione Euro prime.

Rritja dyshifrore e primeve ka ardhur, ndër të tjera, si rezultat i rritjes në fushën e sigurimit të jetës kryesisht në Austri dhe Itali. Për sigurimet e shëndetit dhe të pasurisë, rritja e primeve të Grupit ishte përkatësisht 4.6% dhe 1%. Ndërkohë, kapitali i grupit ka shënuar gjithashtu një rritje prej 6.1% duke arritur 3.3 Miliardë Euro.

Fitimi i konsoliduar, pas taksave, ka shënuar gjithashtu rritje në shifrën 37.5% (76.9 Milionë Euro).

Në prononcimin e tij lidhur me performancën e Grupit në tremujorin e parë, CEO i UNIQA, Z. Andreas Brandstetter shprehet "Ky fillim i mbarë dhe kjo rritje i detyrohet gjithashtu uljes së ndjeshme të shpenzimeve administrative dhe është gjithashtu rezultat i investimeve që kemi bërë."

Prezenca e UNIQA në Shqipëri dhe Rajon

UNIQA është një prej grupeve lider të sigurimeve në Europë. Mbi 22,000 punonjës iu shërbejnë 10 Milionë klientëve në 19 shtete nga të cilat 15 shtete të Europës Qendrore-Lindore.

UNIQA është prezente në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni që prej vitit 2007 përmes kompanisë më të madhe të sigurimeve SIGAL UNIQA duke zotëruar 68.64% të aksioneve të saj. Grupi SIGAL UNIQA një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në rajon të përbërë nga 7 kompani sigurimi dhe 1 Fond Pensionesh të cilët operojnë suksesshëm në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Që prej vitit 2002, SIGAL UNIQA kryeson tregun shqiptar të sigurimeve duke zotëruar mesatarisht 35% të tregut të sigurimeve jetë, jo-jetë dhe pensioneve private. Gjithashtu, kompania renditet e para edhe përsa i përket pagesës së dëmeve: SIGAL UNIQA (Jo-Jetë) ka paguar 31.5% të dëmeve të tregut ku vlen të theksohet fakti se rreth 70% e dëmeve shëndetësore paguhen nga SIGAL UNIQA.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në adresën e mëposhtme:

**Drejtoria e Përgjithshme**

Qendra e Biznesit SIGAL Blv. Zog I , Nr 1 Tirana - Albania

Phone: +355 4 2233308 Fax: +355 4 2250220
E-mail: info@sigal.com.al
Website: www.sigal.com.al

## SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA PUBLIKON TË DHËNAT PARAPRAKE PËR VITIN 2014
## TË ARDHURAT KALOJNË 50 MILIONË EURO

Këtë fundjavë u organizua në Durrës Analiza Financiare 2014 e grupit rajonal SIGAL UNIQA (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni) me pjesëmarrjen e drejtuesve të 8 kompanive të grupit.

Të ardhurat e grupit përgjatë vitit 2014 arritën në 51 Milionë Euro duke shënuar kështu një rekord të ri në historinë 16 vjeçare të kompanisë dhe njëkohësisht një rritje prej 12% në krahasim me një vit më parë. Totali i dëmeve të paguara arriti në 13.8 Milionë Euro.

Duke iu referuar klasifikimit sipas tregjeve në të cilat operojnë, kompanitë SIGAL UNIQA u rritën me përkatësisht:

**SHQIPËRI:**

- **SIGAL UNIQA Group Austria**: e cila operon në tregun e sigurimeve të jo-jetës pati një rritje të volumit të përgjithshëm të primeve prej **16.04%**;

- **SIGAL Life UNIQA Group Austria**: e cila operon në tregun e sigurimeve të jetës pati një rritje në volum primesh prej **14.07%** ndërkohë që rritja e tregut të sigurimeve të jetës ishte 6.93%.

- **Fondi i Pensioneve Private SIGAL Life UNIQA** e cila prej 4 vjetësh ofron pensione private suplementare, u rrit përgjatë 2014-ës me 70.76%.

**MAQEDONI**:

Dy Kompanitë SIGAL UNIQA që operojnë në Maqedoni në tregun e sigurimeve të jetës dhe jo-jetës arritën një volu, primesh prej rreth 11.2 Milionë Euro uke shënuar rritje në krahasim me vitin paraardhës.

**KOSOVË:**

SIGAL UNIQA Kosova e cila ofron sigurime jo-jetë u rrit me 13.55% kurse SIGAL Life UNIQA Kosova (sigurimet e jetës) u rrit ndjeshëm me 41.42%

**ZHVILLIMET NË TREGUN RAJONAL**

Në tregun rajonal të sigurimeve operojnë 41 kompani sigurimi në fushën e jetës dhe jo-jetës. Grupi SIGAL UNIQA është një prej grupeve më të mëdha në rajon dhe zotëron rreth 16% të këtij tregu.

Në Shqipëri, bazuar në raportin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2014, të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2014 kapën vlerën mbi 83 Milionë Euro, ose 36.19% më shumë se në vitin 2013 kurse dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 20 milionë euro, ose 4.67% më shumë se viti 2013.

Kompanitë SIGAL UNIQA udhëhoqën sërish tregun për sigurimet jetë, jo-jetë dhe pensione private duke zënë mesatarisht 35% të tregut, përkatësisht: SIGAL Life UNIQA 64.46% të tregut; SIGAL UNIQA 28.85% të tregut dhe FPP SIGAL Life UNIQA : 46.82% (referuar raportit për periudhën Janar-Shtator 2014).

Në tregun **kosovar** të sigurimeve primet janë rritur me 13.5% duke arritur vlerën 12.4 Milion euro ndërkohë që numri i kontratave eshte rritur me 22% kursen dëmet e paguara janë rritur me rreth 43%. SIGAL UNIQA Kosova është renditur në vend të parë duke zotëruar mesatarisht 15% të tregut të sigurimeve jo-jetë kurse SIGAL Life UNIQA Kosova u rendit e treta në tregun e sigurimeve të jetës me mesatarisht 14.7%.

Totali i primeve të sigurimit në tregun **maqedonas** arriti në mbi 95 Milionë Euro nga të cilat mbi 90% vijnë nga sigurimet jo-jetë dhe vetëm 10% nga sigurimet e jetës. UNIQA a.d renditet në vend të gjashtë me mesatarisht 9.6% të tregut të sigurimeve jo-jetë si dhe ka paguar rreth 9% të dëmeve të këtij tregu. Ndërkohë, UNIQA Life a.d renditet në vend të katërt me 5.2% të tregut dhe ka paguar 0.7% të dëmeve në këtë treg.

## SIGAL UNIQA dëmshpërblen familjarët e dy minatorëve në Komsi, Mat

*Punonjësit humbën jetën në një aksident në minierë*

Më 19 Gusht 2014, në minierën e komunës Komsi në rretin e Matit, si pasojë e një aksidenti humbën jetën punonjësit Xhemal Selaj dhe Donald Barçi përkatësisht minator dhe vagonist.

Të ndjerët, ishin të siguruar tek SIGAL UNIQA përmes skemës së sigurimit nga aksidentet personale në punë të industrisë minerare nga Kompania për të cilën punonin Alba-Co shpk e cila ka siguruar punonjësit e saj në përputhje me ligjin.

SIGAL UNIQA i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjeve të cilët humbën njerëzit e tyre të dashur dhe u qëndron pranë. Në kuadër të detyrimeve të veta kontraktuale, SIGAL UNIQA dëmshpërblen familjet e të ndjerëve Xhemal Selaj dhe Donald Barci në vlerën 6 Milion lekë për secilën prej familjeve. Çeku i dëmshpërblimit iu dorëzua sot familjarëve nga Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Z. Avni Ponari në praninë edhe të përfaqësuesve të firmës minerare.

"*Natyrisht*- u shpreh Z. Ponari- *paratë nuk i kthejnë Xhemalin dhe Donaldin tek ne dhe nuk donim që të takoheshim në këtë formë, pasi do donim që të vazhdonin të jetonin e punonin por fatkeqësisht ka të papriturat e veta. Është për tu vlerësuar kujdesi i drejtuesve të minierës të cilët duke respektuar ligjin për sigurimin e të gjithë minatorëve prej aksidenteve në punë, bënë të mundur që ne ti japim familjeve të Xhemal Selaj dhe Donald Barçit çek prej 6 000 000 lekë për secilin. Shpresoj që familjarët të mund të ndërtojnë një jetë ndryshe dhe sado e vështirë të jetë, të mund tu lehtësohet dhimbja.*'

Përgjatë këtyre viteve, SIGAL UNIQA ka dëmshpërblyer familjarët e minatorëve që kanë humbur jetën si pasojë e aksidenteve në punë, në vlerën totale prej 78 Milionë lekë. Gjithashtu, ka dëmshpërblyer qindra raste të punonjësve të kësaj industrie që kanë pësuar aksidente si pasojë e të cilave ka rezultuar paaftësi e përhershme ose e përkohshme (vetëm në zonën e Bulqizës janë shënuar 9 raste me humbje jete dhe dhjetëra raste me paaftësi).

Motoja kryesore e aktivitetit të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është të respektojë detyrimet kontraktuale. Pagesa në kohë e dëmshpërblimeve për humbjet e jetës dhe ato materiale dëshmon përgjegjshmërinë dhe kujdesin ndaj klientëve si përgjigje për besimin e treguar. Tregues i kësaj përgjegjshmërie është fakti se vetëm në vitin 2014 SIGAL UNIQA ka paguar 10.9 Milionë Euro dëme.

*Sigurimi i detyrueshëm i punonjësve të industrisë minerare*

Të gjithë personat që zotërojnë leje për të ushtruar veprimtari minerare brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të kryejnë sigurimin e punonjësve të tyre nga aksidentet pranë një shoqërie sigurimi. Ky detyrim bazohet në nenin 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 40, të ligjit nr.7961, datë

12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 91 e 93, të ligjit nr.7796, datë 17.2.1994, “Ligji minerar i Shqipërisë”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 1109, datë 8.8.2008.

Referuar bazës ligjore, kontrata e sigurimit mbulon rastet e humbjes së jetës; paaftësisë së përhershme, të plotë ose të pjesshme dhe paaftësisë së përkohshme, të plotë ose të pjesshme dhe shuma në çdo rast është minimalisht 6 Milionë lekë.

*Rreth SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA*

I themeluar në 22 Shkurt 1999, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në rajon të përbërë nga 7 kompani sigurimi dhe 1 Fond Pensionesh të cilët operojnë suksesshëm në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Që prej vitit 2002, SIGAL kryeson tregun shqiptar të sigurimeve duke zotëruar mesatarisht 35% të tregut të sigurimeve jetë, jo-jetë dhe pensioneve private. Gjithashtu, kompania renditet e para edhe përsa i përket pagesës së dëmeve: SIGAL UNIQA (Jo-Jetë) ka paguar 31.5% të dëmeve të tregut ku vlen të theksohet fakti se rreth 70% e dëmeve shëndetësore paguhen nga SIGAL UNIQA.




Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në adresën e mëposhtme:

**Drejtoria e Përgjithshme**

Qendra e Biznesit SIGAL

Blv. Zog I , Nr 1

Tirana - Albania

Phone: +355 4 2233308

Fax: +355 4 2250220

E-mail: info@sigal.com.al

Website: www.sigal.com.al

## SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA PUBLIKON TË DHËNAT PARAPRAKE PËR VITIN 2014
## TË ARDHURAT KALOJNË 50 MILIONË EURO

Këtë fundjavë u organizua në Durrës Analiza Financiare 2014 e grupit rajonal SIGAL UNIQA (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni) me pjesëmarrjen e drejtuesve të 8 kompanive të grupit.

Të ardhurat e grupit përgjatë vitit 2014 arritën në 51 Milionë Euro duke shënuar kështu një rekord të ri në historinë 16 vjeçare të kompanisë dhe njëkohësisht një rritje prej 12% në krahasim me një vit më parë. Totali i dëmeve të paguara arriti në 13.8 Milionë Euro.

Duke iu referuar klasifikimit sipas tregjeve në të cilat operojnë, kompanitë SIGAL UNIQA u rritën me përkatësisht:

**SHQIPËRI:**

- **SIGAL UNIQA Group Austria**: e cila operon në tregun e sigurimeve të jo-jetës pati një rritje të volumit të përgjithshëm të primeve prej **16.04%**;

- **SIGAL Life UNIQA Group Austria**: e cila operon në tregun e sigurimeve të jetës pati një rritje në volum primesh prej **14.07%** ndërkohë që rritja e tregut të sigurimeve të jetës ishte 6.93%.

- **Fondi i Pensioneve Private SIGAL Life UNIQA** e cila prej 4 vjetësh ofron pensione private suplementare, u rrit përgjatë 2014-ës me 70.76%.

**MAQEDONI**:

Dy Kompanitë SIGAL UNIQA që operojnë në Maqedoni në tregun e sigurimeve të jetës dhe jo-jetës arritën një volu, primesh prej rreth 11.2 Milionë Euro uke shënuar rritje në krahasim me vitin paraardhës.

**KOSOVË:**

SIGAL UNIQA Kosova e cila ofron sigurime jo-jetë u rrit me 13.55% kurse SIGAL Life UNIQA Kosova (sigurimet e jetës) u rrit ndjeshëm me 41.42%

## ZHVILLIMET NË TREGUN RAJONAL

Në tregun rajonal të sigurimeve operojnë 41 kompani sigurimi në fushën e jetës dhe jo-jetës. Grupi SIGAL UNIQA është një prej grupeve më të mëdha në rajon dhe zotëron rreth 16% të këtij tregu.

Në Shqipëri, bazuar në raportin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2014, të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2014 kapën vlerën mbi 83 Milionë Euro, ose 36.19% më shumë se në vitin 2013 kurse dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 20 milionë euro, ose 4.67% më shumë se viti 2013.

Kompanitë SIGAL UNIQA udhëhoqën sërish tregun për sigurimet jetë, jo-jetë dhe pensione private duke zënë mesatarisht 35% të tregut, përkatësisht: SIGAL Life UNIQA 64.46% të tregut; SIGAL UNIQA 28.85% të tregut dhe FPP SIGAL Life UNIQA : 46.82% (referuar raportit për periudhën Janar-Shtator 2014).

Në tregun **kosovar** të sigurimeve primet janë rritur me 13.5% duke arritur vlerën 12.4 Milion euro ndërkohë që numri i kontratave eshte rritur me 22% kursen dëmet e paguara janë rritur me rreth 43%. SIGAL UNIQA Kosova është renditur në vend të parë duke zotëruar mesatarisht 15% të tregut të sigurimeve jo-jetë kurse SIGAL Life UNIQA Kosova u rendit e treta në tregun e sigurimeve të jetës me mesatarisht 14.7%.

Totali i primeve të sigurimit në tregun **maqedonas** arriti në mbi 95 Milionë Euro nga të cilat mbi 90% vijnë nga sigurimet jo-jetë dhe vetëm 10% nga sigurimet e jetës. UNIQA a.d renditet në vend të gjashtë me mesatarisht 9.6% të tregut të sigurimeve jo-jetë si dhe ka paguar rreth 9% të dëmeve të këtij tregu. Ndërkohë, UNIQA Life a.d renditet në vend të katërt me 5.2% të tregut dhe ka paguar 0.7% të dëmeve në këtë treg.

# NJOFTIM PËR BASHKËPUNIM

Datë: 01/09/2014

Shoqëria e sigurimeve SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a , në zbatim dhe të detyrimeve përpara Autoritetit të Konkurences fton të gjithë Ndërmjetësit në Sigurime (Brokera dhe Agjente) të cilet ofrojnë kushtet teknike për shitjen online të kontratave të sigurimeve të detyrueshme dhe nëpërmjet sistemit bankar për pagesat sipas legjislacionit ne fuqi, te lidhin kontrata ndermjetesimi me shoqerinë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a me qëllim shitjen e produkteve të sigurimeve të detyrueshme.

Ndërmjetësit ne Sigurime (brokera dhe Agjente) janë të lutur të paraqiten për bashkëpunim pranë shoqerisë, Zyrat Qendrore dhe të shprehin interesin e tyre në adresën: Bulvardi "Zogu I-re", Nr.1, Tiranë-Shqipëri, Kutia postare 2387, Tel: 04 2233 308, email: info@sigal.com.al.

SIGAL UNIQA
UNIQA GROUP AUSTRIA



## SIGAL UNIQA promovon turizmin në Shqipëri.

Promovimi i turizmit malor, njohja dhe ruajtja e traditave të ndryshme të Shqipërisë kanë qenë qëllimi kryesor i një guide turisike 1 ditore, organizuar nga Kompania e Sigurimeve SIGAL UNIQA.

Me nisëm e CEO-së të Kompanisë Z. Avni Ponari rreth 150 përfaqesues të Institucioneve kryesore Financiare në vend si; banka, kompani sigurimesh dhe biznese të ndryshme kanë qënë mysafirë në skajin verior të vendit në **Valbonë,** kjo nisem u pritë mjaft mirë edhe nga Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë Z. Erion Veliaj.

I gjithe itinerari ka qënë si një panoramë e të gjitha bukurive natyrore të vendit tonë. Pas një udhëtimi shumë komodë nga Tirana drejt Komanit, mysafirët e kësaj guide e kanë vijuar rrugëtimin e tyre nëpërmjet liqenit të Fierzës duke shijuar bukuritë përrallore të kësaj pjese të veriut të vendit. Një pritje bufe e bëri edhe më të këndshëm udhëtimin me traget. Me pas udhëtimi ka vijuar përmes rrugës automobilistike ku karvani i makinave ka përshkuar aksin Bajram Curri - Ura e Valbonës, Dragobi.

Valbona është një nga perlat e natyrës shqiptare e cila të përpin në brendësinë e sajë, të bën ta shijosh atë në cdo sekond të qëndrimit në atë vend. Natyra është krejt e virgjër në këto anë ku dora e njeriut duket se nuk ka mundur të bëjë shumë dëme dhe vendasit e kanë ruajtur me fanatizëm. Ushqimet tradicionele dhe mikpritja vendase e bënë edhe më të këndshëm këtë guide turistike.

Kthimi ka një tjetër pjesë të mrekullueshme shqiptare me një itinerar që përfshin edhe Kosovën, duke nisur nga Valbona në Bajram Curri më pas në Gjakovë, Prizren, Kukës dhe Tiranë.

Një udhëtim që ia vlen të provohet një herë në jetë për të parë një nga pjesët më të bukura të Shqipërisë.

Kjo nismë nuk është e para për SIGAL UNIQA. Përgjatë 15 viteve të aktivitetit te saj, SIGAL UNIQA ka organizuar dhe mbështetur aktivitete të shumta të cilat kanë promovuar natyrën dhe kulturën tonë si tek shqiptarët ashtu edhe tek te huajt. Ndër to vlen për tu përmendur vizita e dhjetra biznesmeneve europiane 5 vjet me parë si dhe vizita e një grupi gazetarësh austriake më 2012-n.

No compatible source was found for this video.

UNIQA > Njoftime per shtyp > 15 VJET SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

# 15 VJET SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Kompania më e madhe e sigurimeve në vend, festoi 15 vjetorin e saj.

**Mbrëmja artistike**

Në mbrëmjen artistike të organizuar me këtë rast morën pjesë përfaqësues të lartë të politikës shqiptare, Zëvendëskryeminsitri Niko Peleshi, Kryetari i Parlamentit Ilir Meta, ministra të kabinetit qeveritar, ambasadorë, përfaqësues të financave, bizneseve më të mëdha në vend dhe artistë të shumtë.

Në përshëndetjen e tij Z. Peleshi shprehu mirënjohjen për punën që SIGAL dhe UNIQA kanë bërë përgjatë këtyre viteve për zhvillimin e tregut dhe ekonomisë shqiptare si dhe garantoi mbështetjen e qeverisë shqiptare për zhvillimin e tregut të sigurimeve.

Gjatë mbrëmjes artistike, e cila u drejtua nga prezantuesi Ardit Gjebrea, performuan emra të njohur të artit shqiptar: balerini, solist i Operas Shtetërore të Vjenës Eno Peci, tenori i mirënjohur Josif Gjipali, virtuozi Fatos Qerimi. Artistët u shoqëruan nga orkestra rajonale Klubit të Artit dhe Kulturës të SIGAL UNIQA nën dirigjimin e Mjeshtrit të Madh Ermir Dizdari.

**Konferenca për shtyp**

Bordi Mbikqyrës i SIGAL UNIQA dha në të njëjtën ditë një konferencë për mediat duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve mbi përformancën e SIGAL UNIQA përgjatë 15 viteve, zhvillimet e tregut në Shqipëri dhe planet e UNIQA Insurance Group për Shqipërinë. Në fjalën e tij, Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Z. Avni Ponari foli për arritjet e kompanisë përgjatë këtyre viteve dhe sfidat aktuale të tregut.

Z. Andreas Brandstetter, CEO i UNIQA foli për potencialin e madh që ka tregu shqiptar i sigurimeve për zhvillimin e mëtejshëm të tij veçanërisht përsa i përket sigurimeve të jetës dhe shëndetit.

Dr. Erhard Busek, ish-Koordinator i Paktit të Stabiliteti dhe Antëra i Bordit Mbikëyrës të SIGAL UNIQA u shpreh se suksesi i SIGAL UNIQA është jo thjesht një histori suksesi në Shqipëri por një shenjë e mirë e zhvillimit të të gjithë rajonit.

**Shifra dhe fakte përgjatë 15 viteve**

Në vitin 1999, SIGAL, e cila në atë kohë ishte një kompani e vetme sigurimi jo-jetë me aktivitet vetëm në Shqipëri, kishte një kapital prej 400,000 USD dhe një volum primesh prej rreth 8 milionë Eurob dhe staf prej vetëm pesë personash.

15 vjet më pas, SIGAL UNIQA është shndërruar në një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në rajon, ka mbi 30 Milionë Euro kapitale të vetat, mbi 43 Milionë Euro prime dhe 1100 punonjës dhe agjentë.

Në fillimet e akitivitetit të saj, SIGAL UNIQA ofronte vetëm 3 produkte sigurimi dhe përgjatë viteve ka rritur gamën në 43 produkte të të gjitha klasave të sigurimit.

Përgjatë 15 viteve SIGAL UNIQA ka ruajtur pozicionin si lider i tregut duke zotëruar mesatarisht 30% të tregut ne Shqiperi, si në kohën kur në treg operonin vetëm 5 kompani ashtu edhe sot kur ushtrojnë aktivitetin 12 kompani sigurimi.

Një ndër synimet e Kompanisë që prej fillimit të aktivitetit ka qenë profesionalizmi dhe përgjegjshmëria ndaj klientëve prandaj pagesa në kohë e dëmeve është gjithmonë në plan të parë. Shuma totale e paguar për dëmet materiale dhe shëndetësore të klientëve në të gjithë rajoni, përgjatë 15 viteve arrin shifrën mbi 90 milionë Euro.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, u shpall sërish ketë vit si një ndër 100 kompanitë më të mëdha të Europës Jug-Lindore. Si një grup kompanish i përbërë nga 7 kompani sigurimi dhe 1 fond pensionesh private, SIGAL UNIQA ofron të gjitha llojet e sigurimeve të jetës, jo-jetës, risigurime dhe pensione private më shumë se rreth 1.5 Milionë klientëve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni.

Që prej vitit 2002, SIGAL UNIQA është lider i tregut të sigurimeve si për dëmet e paguara ashtu edhe për volumin e primeve. Përgjatë viteve SIGAL UNIQA është vlerësuar në nivel ndërkombëtar nga institucione të ndryshme si Bussiness Initiative Directions, South-East Europe Neës, Finance Central Europe etj.




**BROSHURA SPECIALE 15 VJET SIGAL**

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ka publikuar broshurën 15 vjet SIGAL.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në publicrelations@sigal.com.al

UNIQA > Njoftime per shtyp > SEE News rendit SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ndër 100 kompanitë më të mira në Europën Jug-Lindore

## SEE News rendit SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ndër 100 kompanitë më të mira në Europën Jug-Lindore

South-East European News, një institucion që vlerëson performancën ekonomike të shteteve të Europës Jug-Lindore dhe kompanive që operojnë në këto shtete, ka vlerësuar, për të gjashtin vit radhazi SIGAL UNIQA Group AUSTRIA si një ndër kompanitë më të mira të sigurimeve në rajon.

**Vlerësimi**

SIGAL UNIQA është kompania e vetme shqiptare që është në listën e 100 siguruesve të mirë në rajon. Në listë analizohen rreth 2000 subjekte financiare dhe jo-financiare prej të cilave përzgjidhen vetëm 100 kompanitë më të mira.

Në këtë vlerësim janë përfshirë gjithashtu edhe kompanitë e tjera të grupit UNIQA që operojnë në Serbi, Rumani, Bullgari, Bosnje-Hercegovinë dhe Kroaci, të cilat kanë përforcuar pozicionet në krahasim me një vit më parë. Një vlerësim I tillë përforcon edhe më shumë imazhin e UNIQA Group AUSTRIA si një grup I fuqishëm financiar në të gjithë rajonin e Europës Qëndrore- Lindore dhe Jug-Lindore.

**15 vjet SIGAL UNIQA në Shqipëri**

Themeluar që në vitin 1999, SIGAL UNIQA kompania më e madhe e sigurimeve në vend do të festojë pas pak muajsh 15 vjetorin e fillimit të aktivitetit në Shqipëri. Muajin e kaluar SIGAL UNIQA festoi 10 vjetorin e partneritetit me Fondin Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, investim i Kongresit Amerikan, i cili ka vlerësuar bashkëpunimin me SIGAL UNIQA si një histori suksesi. Gjithashtu, pak ditë më parë në një mbrëmje gala në Prishtinë u festua 10 vjetori i SIGAL UNIQA Kosova e cila me këtë rast vlerësoi 10 personalitete kosovare bazuar në propozimet e publikut. Në këtë përvjetor, SIGAL UNIQA Kosova inauguroi gjithashtu edhe zyrat e reja qendrore të cilat janë tashmë një tjetër aset i kompanisë falë një investimi prej rreth 2.5 Milionë Euro.

**Rreth SIGAL UNIQA Group Austria**

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA është një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në rajon i cili përbëhet nga 7 kompani sigurimi dhe 1 Fond Pensionesh: SIGAL UNIQA Group AUSTRIA (Jo-Jetë, Shqipëri), SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA (Jetë, Shqipëri), SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Risigurime, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Kosova (Jo-Jetë, Kosovë), SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA Kosova (Jetë, Kosovë), UNIQA a.d (Jo-Jetë, Maqedoni), UNIQA Life a.d (Jetë, Maqedoni) dhe Fondi i Pensioneve Private SIGAL Life UNIQA Group AUSTRIA.

Që prej vitit 2002, SIGAL është udhëheqës i tregut duke zotëruar mesatarisht 32% të tregut të sigurimeve jetë, jo-jetë dhe pensioneve private në vend si dhe është udhëheqës i tregut edhe përsa i përket pagesës së dëmeve.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në publicrelations@sigal.com.al

UNIQA > Njoftime per shtyp > Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve 10 vjet në SIGAL

## Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve 10 vjet në SIGAL

*Festohet 10-vjetori i bashkëpunimit mes Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve dhe SIGAL UNIQA Group AUSTRIA*

Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve (F.SH.A.N) është investitori i parë i huaj që hyri në tregun shqiptar të sigurimeve në një kohë kur tregu ishte i sapo-formuar dhe ende në hapat e tij të parë, 10 vjet më parë. Marrëveshja e bashkëpunimit të cilën F.SH.A.N dhe SIGAL nënshkruan dhjetë vjet më parë shënoi një arritje të rëndësishme për të gjithë tregun e sigurimeve dhe jo vetëm për SIGAL për të cilin F.SH.A.N u bë aksioner. Me rastin e 10-vjetorit të kësaj marrëveshjeje, Bordi i F.SH.A.N zhvilloi ditën e djeshme një takim dhe konferencë për shtyp në zyrat e SIGAL UNIQA.

Në përshëndetjen e tij, Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Avni Ponari, falënderoi F.SH.A.N për mbështetjen dhe besimin e treguar si dhe u ndal në disa nga arritjet e SIGAL UNIQA përgjatë 10 viteve.

Falë mbështetjes së F.SH.A.N, SIGAL u shndërrua nga një kompani lokale në grupin më të madh rajonal të sigurimeve të përbërë nga 8 kompani. Performanca shumë e mirë financiare dhe suporti i FSHAN mundësuan hyrjen e një tjetër investitori strategjik në fushën e sigurimeve në vitin 2007 përmes bashkëpunimit me UNIQA Group AUSTRIA i cili është aktualisht aksioneri më i madh i SIGAL UNIQA. UNIQA Group Austria është një prej kompanive më të fuqishme financiare në Europën Qendrore-Lindore, e vlerësuar me 'A' nga 'Standard&Poor's' dhe prezente në 21 shtete. Pjesë e programit së UNIQA-s dhe sfida për të ardhmen e afërt është investimi në sektorë të tjerë strategjikë në Shqipëri, krahas sigurimeve.

Në fjalën e tij, Presidenti i F.SH.A.N Michael Granoff, ndër të tjera,u shpreh:

*"Ne jemi krenarë që jemi pjesë e kësaj kompanie dhe e këtij partneriteti. Ky investim i yni është një histori suksesi pasi ne kemi hyrë në tregun e sigurimeve për ta ndryshuar atë dhe në 10 vjet SIGAL e ka arritur. Shembulli flet vetë pasi nga disa zyra janë shndërruar në qindra dhe nga disa punonjës tani janë disa mijëra. Së bashku me SIGAL kemi dhënë kontributin për të zhvilluar sektorin e sigurimeve. SIGAL synynon që të transformohet në një kompani udhëheqëse edhe në rajon kjo sepse tregu i sigurimeve është një treg me potencial të jashtëzakonshëm."*

Në sajë të investimeve të UNIQA dhe F.SH.A.N, dy partnerë të rëndësishëm strategjikë, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ka krijuar më shume besim e garanci për klientët dhe tregun e sigurimeve në tërësi, jo vetëm në Shqipëri por në të gjithë rajonin duke synuar ti japë vendin e merituar industrisë së sigurimeve si një prej 3 shtyllave kryesore të zhvillimit të çdo vendi.

### SIGAL UNIQA në 10 vjet

Në vitin 2003, SIGAL kishte një kapital prej 2 milionë Euro dhe një volum primesh prej rreth 8 milionë Euro. 10 vjet më pas, SIGAL UNIQA ka mbi 26 Milionë Euro kapitale të vetat dhe mbi 39 Milionë Euro prime. Përgjatë 10 viteve SIGAL ka ruajtur pozicionin si lider i tregut duke zotëruar mesatarisht 30% të tregut, si kur në treg operonin vetëm 5 kompani ashtu edhe sot kur ushtrojnë aktivitetin 12 kompani sigurimi.

**Rreth FSHAN**

Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve është themeluar me iniciativë dhe vendim të Kongresit Amerikan në vitin 1995 në kuadër të marrëveshjes “Për Demokracitë e Europës Lindore”. Qëllimi kryesor i F.SH.A.N është të promovojë zhvillimin e sektorit privat duke investuar ose dhënë hua një game të gjerë sipërmarrjesh private përmes dhënies së udhëzimeve dhe këshillave lidhur me menaxhimin. F.SH.A.N drejtohet nga menaxherë profesionistë të investimeve të cilët udhëhiqen nga Bordi i Drejtorëve të cilët emërohen nga Presidenti i SH.B.A.

**Rreth SIGAL UNIQA Group Austria**

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, u shpall sërish ketë vit si një ndër 100 kompanitë më të mëdha të Europës Jug-Lindore. Si një grup kompanish i përbërë nga 7 kompani sigurimi dhe 1 fond pensionesh private, SIGAL UNIQA ofron të gjitha llojet e sigurimeve të jetës, jo-jetës, risigurime dhe pensione private më shumë se rreth 500,000 klientëve. Që prej vitit 2002, SIGAL UNIQA është lider i tregut të sigurimeve si për dëmet e paguara ashtu edhe për volumin e primeve.

Përgjatë viteve SIGAL UNIQA është vlerësuar në nivel ndërkombëtar nga institucione të ndryshme si Bussiness Initiative Directions, South-East Europe News, Finance Central Europe etj.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në publicrelations@sigal.com.al

UNIQA > Njoftime per shtyp > Festohet dekada e parë e operimit në Kosovë

# Festohet dekada e parë e operimit në Kosovë

*Kompania më e madhe e sigurimeve në Shqipëri, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ka hyrë në dekadën e dytë të aktivitetit në Kosovë.*

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA operon në Kosovë që prej 23 Tetorit 2003, datë në të cilën SIGAL Kosova filloj aktivitetin për të operuar në fushën e sigurimeve jo-jetë. Përgjatë këtyre 10 viteve, SIGAL Kosova ka shënuar shumë arritje falë të cilave ka pasur një zhvillim të qëndrueshëm duke ruajtur standardet dhe parametrat e saj. Pak pas fillimit të aktivitetit SIGAL Kosova arriti një pozicion të mirë në treg dhe përgjatë gjithë periudhës ka zotëruar mesatarisht 15% të tregut pavarësisht rritjes së numrit të kompanive që operojnë në të.

Në historinë e saj 10-vjeçare SIGAL Kosova arriti të bëhej pjesë e një prej grupeve më të mëdha financiare në Europë, UNIQA Group AUSTRIA i cili i ka mundësuar një mbështetje të fortë financiare industrisë së sigurimeve dhe financave në Kosovë. Duke konsideruar faktin se sigurimet ende kanë një penetrim shumë të ulët në ekonominë kosovare, rreth 40 Euro/frymë, ndërkohë që mesatarja në Europë është rreth 1800 Euro/frymë, tregu kosovar i sigurimeve ashtu sikurse ai shqiptar dhe maqedonas paraqesin një potencial shumë të lartë investimi dhe zhvillimi dhe si të tillë përbëjnë një interes të madh për UNIQA-n si aksioneri më i madh i grupit SIGAL UNIQA. Dy vjet më parë grupi SIGAL UNIQA Group AUSTRIA investoi sërish në Kosovë duke krijuar simotrën e saj SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Jetë. Falë këtij investimi dhe kujdesit të aksionerëve dhe SIGAL UNIQA Shqipëri, u mundësua plotësimi i të gjithë gamës së sigurimeve edhe në Kosovë duke iu ofruar klientëve produkte bashkëkohore në të gjitha klasat e jetës dhe jo-jetës.

Një ndër synimet e Kompanisë që prej fillimit të aktivitetit ka qenë profesionalizmi dhe përgjegjshmëria ndaj klientëve prandaj pagesa në kohë e dëmeve është gjithmonë në plan të parë. Shuma totale e paguar për dëmet materiale dhe shëndetësore të klientëve në Kosovë arrin shifrën mbi 20 milionë Euro në harkun kohor të 10 vjetëve. Gjithashtu, duke qenë e ndërgjegjshme edhe për përgjegjësinë e vet sociale, SIGAL UNIQA Kosova ka kontribuar gjithmonë në zhvillimin e mëtejshëm të artit dhe sportit në Kosovë veçanërisht në fushat e basketbollit dhe kinematografisë. Skuadra e basketbollit që mban emrin e Kompanisë, SIGAL Prishtina është kampion kombëtar dhe një përfaqësues i denjë i basketbollit kosovar në kampionatet ndërkombëtare dhe SIGAL Kosova është krenar për mbështetjen e vazhdueshme.

**Festimi i 10 vjetorit**

Në këtë përvjetor, SIGAL UNIQA Kosova inauguron zyrat e reja të Drejtorisë së Përgjithshme të cilat tashmë janë një aset i kompanisë falë një investimi prej 2.5 mil Euro. Megjithatë, e veçanta e festimit të këtij 10-vjetori ishte organizimi i mbrëmjes gala '10 vjet, 10 histori suksesi' gjatë të cilit SIGAL UNIQA Kosova vlerësoi 10 personalitete kosovare të cilët u nominuan nga publiku kosovar përgjatë disa javëve përmes faqes zyrtare të kompanisë.

**Grupi SIGAL UNIQA përgjatë 10 viteve**

Në vitin 2003, SIGAL, e cila në atë kohë ishte një kompani e vetme sigurimi jo-jetë me aktivitet vetëm ne Shqipëri, kishte një kapital prej 2 milionë Euro dhe një volum primesh prej rreth 8 milionë Euro. 10 vjet më pas, SIGAL UNIQA është shndërruar në një prej grupeve më të mëdha të sigurimeve në rajon, ka mbi 26 Milionë Euro kapitale të vetat dhe mbi 39 Milionë Euro prime. Përgjatë 10 viteve SIGAL ka ruajtur pozicionin si lider i tregut duke zotëruar mesatarisht 30% të tregut ne Shqiperi, si në kohën kur në treg operonin vetëm 5 kompani ashtu edhe sot kur ushtrojnë aktivitetin 12 kompani sigurimi.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, u shpall sërish ketë vit si një ndër 100 kompanitë më të mëdha të Europës Jug-Lindore. Si një grup kompanish i përbërë nga 7 kompani sigurimi dhe 1 fond pensionesh private, SIGAL UNIQA ofron të gjitha llojet e sigurimeve të jetës, jo-jetës, risigurime dhe pensione private më shumë se rreth 500,000 klientëve. Që prej vitit 2002, SIGAL UNIQA është lider i tregut të sigurimeve si për dëmet e paguara ashtu edhe për volumin e primeve. Përgjatë viteve SIGAL UNIQA është vlerësuar në nivel ndërkombëtar nga institucione të ndryshme si Bussiness Initiative Directions, South-East Europe Neës, Finance Central Europe etj.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në publicrelations@sigal.com.al

UNIQA > Njoftime per shtyp > SIGAL UNIQA vlereson 10 personalitetet me te votuara nga publiku kosovar

## SIGAL UNIQA vlereson 10 personalitetet me te votuara nga publiku kosovar

Personalitetet e 10 fushave të ndryshme u vlerësuan gjatë spektaklit "10 Vjet, 10 Histori Suksesi" i cili u organizua ne RTV 21. Emrat u propozuan nga publiku Kosovar përmes votimit online në www.sigal-ks.com.

1. Qendrim Gashi-matematicien; mori diplome universitare qe ne moshen 16 vjeçare dhe doktoraturen ne moshen 23 vjecare duke hyre keshtu ne historine e matematikes boterore si nje nder personat me te rinj me te tilla rekorde. Aktualisht nje Doktor Profesor i Asociuar, z. Gashi u vleresua nga SIGAL UNIQA per gjenialitetin e tij te rradhe ne fushen e matematikes.

2. Majlinda Kelmendi- kampionia boterore e xhudos; ka marre vleresimin maksimal te SIGAL UNIQA e cila ka qene gjithmone ne mbeshtetje te sportit. Znj. Kelmendi ka perfaqesuar denjesisht Shqiperine dhe Kosoven ne kampionatet nderkombetare te xhudos duke shenuar arritje te njepasnjeshme.

3. Idriz Ajeti: akademik; eshte nje nder shembujt me te mire se mosha eshte vetem nje numer dhe nuk percakton domosdoshmerisht performancen e nje njeriu. Ndonese ne moshen 96 vjecare, z. Ajeti vazhdon te punoje ne fushen e akademise duke sjelle gjithmone botime dhe studime mjaft te vlefshme per gjuhen dhe letersine Kosove. SIGAL UNIQA vlereson thellesisht kontributin e vazhdueshem akademik te Z. Ajeti duke i uruar nje jete sa me te gjate.

4. Dhurata Bardoniqi-biznesmene; SIGAL UNIQA eshte e bindur se pas ekonomive te fuqishme qendron nje sektor privat i suksesshem te cilin e zhvillojne njerez me vizion dhe plane te qarta per te ardhmen si biznesmenia Dhurata Bardoniqi te cilen SIGAL UNIQA e vlereson vecanerisht per forcen qe ka treguar ne perballimin e sfidave te medha te jetes duke i mbijetuar semundjes si dhe per kontributin te madh ne zhvillimin e ekonomise kosovare dhe mbeshtetjen per promovimin e femrave ne biznes.

5. Visar Kuci: instrumentist; Si nje Kompani qe promovon artin, SIGAL UNIQA perzgjodhi Visar Kucin si nje nder artistet e rinj dhe shume premtues ne Kosove i cili performon pese instrumente muzikore me mjeshteri: violine, kitare, viole, violincel dhe bateri. Nisur nga performancat e tij, Z. Kuci ka te gjitha gjasat per perfaqesuar denjesisht artin kosovar ne skenat me te medha nderkombetare.

6. Fatos Lajci-Regjisor; i cili la Hollywod-in per tiu perkushtuar inciativave dhe projekteve ambientaliste ne Kosove. SIGAL UNIQA mbeshtet fuqishem dhe promovon zhvillimin e qendrueshem, vlereson tej mase perpjekjet dhe rezultatet qe ka arritur ambientalisti Fatos Lajci ne saje te te cilit Bjeshket e Namura eshte shpallur Park Kombetar dhe i mbrojtur nga shteti.

7. Jeton Vorfi-koeograf; Ndonese i diplomuar per mjekesi, eshte gjeresisht i njohur per aftesite e tij koreografike dhe nje nder balerinet me te zote ne Kosove. I detyruar te zgjedhe midis dy pasioneve te tij

te medha, z. Vorfi vendosi ti kushtohet koreografise duke sjelle gjithmone risi me performancen e tij ne fushen e spektaklit ne Kosove.

8. Armend Malazogu: i diplomuar per Shkenca Informative por njihet me se shumti si nje nder fermeret me te suksesshem ne Kosove. Z. Malazogu ka marre vlerësimin e SIGAL UNIQA per përkushtimin e tij maksimal ne ofrimin e produkteve 100% bio te tokes se Kosoves. SIGAL UNIQA promovon produktet shqiptare pasi beson thellësisht ne zhvillimin e ekonomise se vendit edhe nga kompanite lokale.

9. Anton Cetta: pajtues gjaqesh; SIGAL UNIQA ka vleresuar punen e madhe te te ndjerit Anton Cetta si pioner i pajtimit te gjaqeve ne te gjithe zonen e Kosoves duke e cilesuar ate si nje nobelist te paqes. Fale kembenguljes dhe aktivitetit te palodhur te z. Cetta, qindra familje kosovare i kane dhene hund hasmerive duke i mundesuar brezave nje te ardhme te qete dhe te paqte e cila nuk do te ishte me peng i se shkuares.

10. Stafi i SIGAL UNIQA Kosova ka perfaqesuar te vleresuarit e 10-te ne kete pervjetor te kompanise. Pas cdo suksesi dhe arritje te SIGAL UNIQA Kosova qendron nje staf i perkushtuar profesionistesh te cilet kane vene ne dispozicion te qidnra mijera klienteve aftesite dhe njohurite e tyre per ofrimin e nje sherbimi cilesor pergjate ketyre viteve.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në publicrelations@sigal.com.al

UNIQA > Njoftime per shtyp > Presidenti Nishani dekoron me urdhrin ‘Mjeshtër i Madh’ z. Ermir Dizdari, Drejtor i Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

## Presidenti Nishani dekoron me urdhrin ‘Mjeshtër i Madh’ z. Ermir Dizdari, Drejtor i Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Presidenti i Republikës, Bujar Nishani nderoi pak ditë më parë disa nga figurat e shquara të qytetit të Durrësit, ndër të cilët Dirigjentin e mirënjohur, njëkohësisht Drejtorin e Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA, z. Ermir Dizdari. Në veprimtarinë e zhvilluar në Pallatin e Kulturës “Aleksandër Moisiu”morën pjesë Kryetari i Bashkisë, z. Vangjush Dako; Ministri i Drejtësisë, z. Eduard Halimi, deputetë dhe qytetarë durrsakë.

Në fjalën përshëndetëse të mbajtur para qytetarëve durrsakë, Presidenti Nishani u shpreh se qyteti i Durrësit ka qenë teatër i ngjarjeve nga më dramatiket dhe më të rëndësishmet për fatet e Shqipërisë, duke u shquar për lashtësinë e tij, shembullin e bashkëjetesës mes besimeve fetare, si dhe për personalitetet e shquar që i ka dhënë vendit. Në fjalën e tij, z. Nishani theksoi se nderimi dhe respektimi i punës së çdo profesionisti në fushën e tij, është jo vetëm një detyrë e shtetit por edhe një nga shtyllat që një vend të ecë përpara dhe zhvillohet nga puna e çmuar dhe e dobishme e secilit qytetar.

Në këtë vlerësim janë përfshirë artistë si dirigjenti i aq shumë festivaleve folklorike dhe festivaleve ndërkombëtare, z. Ermir Dizdari.

**Dirigjenti Ermir Dizdari**

Në vitin **1966**, pas mbarimit të Konservatorit emërohet në qytetin e Durrësit. Ishte kuadri i parë i këtij rrethi, më shkollë të lartë, i kompletuar, në profilin e muzikës, por edhe me eksperiencë pune nga veprimtaritë e ndryshme muzikore dhe artistike që kishte drejtuar gjatë kohës si student.

Që në fillim caktohet Shef–muzike dhe dirigjent në Pallatin e Kulturës “Aleksandër Moisiu” të Durrësit.

Në **Tetor 1966** iu besua drejtimi i Ansamblit Artistik të Durrësit në Takimin kombëtar të ansambleve artistike, që u zhvillua në skenën e Teatrit “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Vazhdoi të drejtojë Ansamblin Artistik të Durrësit në takimet kombëtare të ansambleve artistikë në **Prill 1969**, në Vlorë; në **Tetor 1974**, në Durrës; në **Tetor 1984**, në Durrës. Në këto veprimtari ansambli është vlerësuar me çmime të ndryshme.

Në **Janar 1968** vetëm një vit e gjysëm pas mbarimit të Konservatorit ndonëse në rrethin e Durrësit kishte një ekip muzikantësh me përvojë dhe shumë të afirmuar, Ermir Dizdarit iu besua një tjetër veprimtari tepër e veçantë: drejtimi i operas së parë në Durrës: **“Bijtë e Skënderbeut”**, kompozuar nga A.Grimci, me libret të M.Gjelucit. Me vënien në skenë të kësaj opere, u bë për herë të parë rreshtimi i kompletuar i

formacionit të orkestrës simfonike dhe, më vonë, brenda tij si formacion më vete edhe i orkestrës së harqeve.

Për shumë vite me radhë ka dhënë një ndihmesë të madhe në drejtimin e Bandës muzikore të qytetit, duke e plotësuar me elementë dhe repertor të ri. Në këtë periudhë drejtoi disa nga Festivalet e Këngës për Fëmijë dhe Pionierë, organizuar nga Shtëpia e Pionierit, si dhe Festivalet për të rritur, të organizuara nga Pallati i Kulturës "A.Moisiu", Durrës.

Krahas punës si përgjegjës muzike dhe dirigjent është marrë edhe me organizimin e veprimtarive të shumta të trashëgimisë shpirtërore. Më një punë të madhe të tij dhe një ekspeditë qw zhvilloi në fshatrat e thella të rrethit të Durrësit, u ngrit Ansambli Popullor "Durrësi", që mori pjesë në Festivalin e Parë Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës në **Tetor 1968**, ku fitoi çmimin e tretë, i vetmi çmim i marrë nga Durrësi në të gjitha edicionet e Festivalit të Gjirokastrës.

Me krijimin e shkollës së mesme artistike "Mujo Ulqinaku" në Durrës, emërohet drejtor artistik dhe jep një ndihmesë të rëndësishme në hapjen e degëvë të reja, që u mungonin formacioneve muzikore të qytetit të Durrësit si: flaut, oboe, fagot, violë, kontrabas, etj. Si dirigjent i orkestrës së shkollës së muzikës , me nxënës dhe pedagogë, përveç veprimtarive të tjera muzikore ka marrë pjesë në disa takime kombëtare të shkollave të mesme artistike. Në një nga këto takime, me këtë formacion u arrit të ekzekutoheshin vepra muzikore, si Simfonia në Re Maxhor të J. Hajden, etj.

Në vitin **1986**, pas një eksperience të gjatë si drejtues i drejpërdrejtë i shumë veprimtarive muzikore në Durrës, transferohet në Tiranë, në Ministrinë e Arsimit dhe të Kulturës dhe më pas, në Komitetin e Kulturës dhe Arteve me detyrën specialist muzike në drejtorinë e Arteve. Më vonë ka kryer detyrat: Drejtor i Ansamblit Shtetëror të Këngëve dhe Valleve Popullore dhe më pas, drejtor i Qendrës Kombëtare të Veprimtarive Folklorike.

Gjatë kësaj periudhe ka drejtuar disa veprimtari muzikore si koncert me rastin e 100-vjetorit të Shkollës së Parë Shqipe, në Korçe; koncert me rastin e 75-vjetorit të Pavarësisë në Vlorë; Festivali Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës.

Ka drejtuar herë pas here Orkestrën Simfonike të Teatrit të Operas dhe Baletit, atë të Radio Televizionit Shqiptar, orkestrën e muzikës së dhomës të Institutit të Lartë të Arteve, duke ekzekutuar vepra të kompozitorëve Ç.Zadeja, T.Daija, P.Gaci, Bach, Vivaldi, Moxart, Bethoven, Shubert, etj., si dhe mjaft vepra orkestrale dhe simfonike në shoqërim të instrumentistëve të ndryshëm si: Muharrem Denisi, Gjergj Antoniu, Anton Berovski, Arjan Paço, Vangjush Papadhimitri, Pandush Gjezi, Renato Ripo, Edmond Malolli, etj.

Në këtë periudhë u kushtohet në mënyrë të veçantë trashëgimisë shpirtërore të popullit tonë dhe veprimtarive të shumta në këtë fushë. Që nga viti **1968**, punon për sistemimin dhe institucionalizimin e vempritarive folklorike kombwtare, rajonale dhe lokale, duke i vendosur sipas zonave përkatëse etnografike, mbi bazwn e rregullave dhe kritereve organizative dhe shkencore, duke krijuar strukturat e grupeve sipas trashwgimisw së secilës zonë etnografike.

Mbi këtë bazë drejtoi punën për organizimin dhe zhvillimin periodiket edhe ta 4 Festivaleve Folklorike Kombwtare: ai i Sazeve në Korçe; i Polifonisë në Vlorë; i Rapsodëve dhe Instrumentistëve në Lezhë; dhe Festivali i Këngës Qytetare në Elbasan.

Kontribut kryesor ka dhënë në organizimin e Festivalit Folklorik Kombwtar të Gjirokastrës. Ka qenë drejtor i Festivaleve Folklorike Kombëtare në Gjirokastër të viteve **2000** dhe **2004**.

Edhe pas daljes në pension në vitin **2006**, Ermir Dizdari nuk e ndërpret punën e tij plot pasion në fushën e artit muzikor dhe folklorik, por vazhdon të japë ndihmesën e tij në veprimtari të ndryshme folklorike brenda dhe jashtë vendit. Ka qene drejtor i Festivalit Folklorik Mesdhetar, në Vlorë; i Festivalit Folklorik "Bylipolifonia", në Mallakastër; i Revistës së Folklorit Burimor të Drenasit në Kosovë, në vitet 2006 dhe 2010. Ka dhënë dhe jep ndihmesën e tij në promovimin e trashëgimisë shpirtërore të shqiptare, si këngëve, valleve, melodive, kostumeve dhe instrumenteve popullore përmes veprimtarive të ndryshme në shumë vende të botës.Ka marrë pjesë në diskutime, konsulta, intervista të ndryshme, duke dhënë mendime për probleme të muzikës, në përgjithësi, dhe të folklorit në veçanti. Ka botuar në shtyp, artikuj me karakter informues ose problemor. Ka botuar dy libra për Festivalin Folklorik Kombëtar të Gjirokastrës të viteve 2000 dhe 2004.

Për përvojën që ka, prej më shumë se 10 vjetësh është anëtar i Këshillit Artistik, si dhe i bordit të Teatrit të Operas dhe Baletit dhe Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore, ku vazhdon edhe sot.

Prej 12 vjetësh kryen aktivitet pedagogjik, duke dhënë mësim si pedagog i jashtëm në Universitetin e Arteve ku vazhdon edhe sot.

**Vlerësime të mëparshme**

Për këtë veprimtari të gjerë dhe shumëplanëshe është vlerësuar me mirënjohje, diploma, fletë nderi, etj.

Nga shoqata "Durrësi" dhe nga Bashkia Durrës është nderuar me titut "Mirënjohje e Qytetit" dhe "Nderi i Qytetit të Durrësit".

Ka disa medalje dhe urdhra, si: medaljen "Naim Frashëri", urdhrat "Naim Frashëri" të klasit të III, II, I.

Nga Presidenti i Republikës ka marrë dekoratën "Naim Frashëri i Artë".

**Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA Group AUSTRIA**

Inauguruar që prej 4 vjetësh në një prej zonave kryesore të Durrësit, Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL UNIQA është një risi dhe unik për nga lloji. Klubi i Artit ndërthur muzikën, letërsinë dhe artet figurative në një vend të vetëm dhe si i tillë është shumë i preferuar nga artistët për organizimin e ekspozitave të piktures (përfshirë të skulpturës dhe fotografive), promovimin e librave dhe muzikën e dhomës.

Vetëm në 2 muajt e fundit, në Klubin e Artit dhe Kulturës janë zhvilluar aktivitete të rëndësishmë kulturore të tilla si ekspozita personale e piktores së mirënjohur Lume Blloshmi, Koncerti i trios akademike ( me instrumentistë Fatos Qerimaj-klarinetë, Merita Rexha-piano dhe Arben Llozi-violë) si dhe promovime librash dhe ekspozita pikture të artistëve të njohur dhe të rinj.

Në javët në vijim, Klubi i Artit dhe Kulturës, nën drejtimin e z. Dizdari do të organizojë ekspozitën e piktores kosovare Agnesa Muharremi, portret artisti të pianists Rudina Ciko, promovimin e librit të poetit Ruzhdi Gole, mbrëmje muzikore me pedagodë dhe instrumentistë të Universitetit të Arteve etj.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në publicrelations@sigal.com.al

UNIQA > Njoftime per shtyp > Promovohet libri përmbledhës i vempritarisë së Artistit të Popullit Reshat Arbana

## Promovohet libri përmbledhës i vempritarisë së Artistit të Popullit Reshat Arbana

Mbrëmjen e djeshme u organizua ceremonia për promovimin e librit-album për vempritarinë artistike të Ndertit të Kombit Reshat Arbana. Libri u përgatit për botim nga SIGAL UNIQA, nën kujdesin personal të Drejtori të Përgjithshëm, z. Avni Ponari.

Në ceremoni morën pjesë artistë të shumtë, miq të aktorit të madh Reshat Arbana dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme kulturore në vend.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në publicrelations@sigal.com.al

UNIQA > Njoftime per shtyp > Pozicioni në treg SIGAL UNIQA Group AUSTRIA: Janar-Qershor 2012

## Pozicioni në treg SIGAL UNIQA Group AUSTRIA: Janar-Qershor 2012

Buletini Statistikor, publikim i Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për periudhën Janar-Qershor 2012 tregon përforcim të mëtejshëm të vendit kryesues që Kompania ka në tregun shqiptar të sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës.

Më konkretisht, **SIGAL UNIQA** është në vend të parë me rreth **31.83%** të volumit të përgjithshëm të primeve për sigurimet e Jo-Jetës si dhe ka paguar 26.16% të dëmeve të tregut.

Të klasifikuara sipas produkteve, SIGAL UNIQA udhëheq tregun duke zotëruar përkatësisht:

- **26.68%** të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimet Motorike
- **25.57%** të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimin Karton Jeshil
- **38.22%** të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimi i Pasurisë
- **47.98%** të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimin e Aksidenteve Personale dhe Shëndetit

Ndërkohë që SIGAL Life UNIQA ka vazhduar të forcojë prezencën në treg duke zotëruar **41.81%** të volumit të përgjithshëm të primeve për sigurimet e jetës. Përsa i përket pagesës së dëmve për këtë fushë të sigurimeve, SIGAL Life UNIQA ka paguar **33.61%** të dëmeve totale të tregut.

Për më shumë informacion, klikoni www.amf.gov.al

UNIQA > Njoftime per shtyp > Pozicioni në treg SIGAL UNIQA Group AUSTRIA: Janar-Qershor 2012

# Pozicioni në treg SIGAL UNIQA Group AUSTRIA: Janar-Qershor 2012

Buletini Statistikor, publikim i Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për periudhën Janar-Qershor 2012 tregon përforcim të mëtejshëm të vendit kryesues që Kompania ka në tregun shqiptar të sigurimeve të Jetës dhe Jo-Jetës.

Më konkretisht, **SIGAL UNIQA** është në vend të parë me rreth **31.83%** të volumit të përgjithshëm të primeve për sigurimet e Jo-Jetës si dhe ka paguar 26.16% të dëmeve të tregut.

Të klasifikuara sipas produkteve, SIGAL UNIQA udhëheq tregun duke zotëruar përkatësisht:

- **26.68%** të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimet Motorike
- **25.57%** të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimin Karton Jeshil
- **38.22%** të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimi i Pasurisë
- **47.98%** të volumit të përgjithshëm të primeve për Sigurimin e Aksidenteve Personale dhe Shëndetit

Ndërkohë që SIGAL Life UNIQA ka vazhduar të forcojë prezencën në treg duke zotëruar **41.81%** të volumit të përgjithshëm të primeve për sigurimet e jetës. Përsa i përket pagesës së dëmve për këtë fushë të sigurimeve, SIGAL Life UNIQA ka paguar **33.61%** të dëmeve totale të tregut.

Për më shumë informacion, klikoni www.amf.gov.al

# Armët e Skënderbeut vijnë për herë të parë në Shqipëri me mbështetjen e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

Në datë 22 Nëntor u zhvillua në Muzeun Historik Kombëtar ceremonia e hapjes së ekspozitës 'Armët e Skënderbeut' në të cilën ekspozohen për herë të parë për publikun shqiptar përkrenarja, 2 shpatat, gravura e përmasave të mëdha dhe kodeksi i jetës së Skendërbeut.

Armët erdhën në Shqipëri me mbështetjen e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, Fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve, Fondacionit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit dhe Raiffeisen Bank.

**Sigurimi**

Armët, përkrenarja, kodeksi dhe gravura me vlerë 35 Milionë Euro janë siguruar nga kompania më e madhe e sigurimeve në vend. Sigurimi i një pasurie të tillë me vlera të mëdha historike për Shqipërinë është në përputhje me strategjinë e SIGAL UNIQA për mbrotjen e trashëgimisë kulturore dhe historike duke e siguruar atë.

Në këtë kuadër, SIGAL UNIQA është siguruesi i Teatrit Skampa ( rindërtuar pak muaj më parë falë dëmshpërblimit të SIGAL), i disa shtëpive tradicionale 2400 vjecare të Beratit dhe i shumë insitucioneve kulturore brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**Koleksioni**

Armët janë pjesë e koleksionit të Muzeut të Historisë së Artit Vjenë. Shpata dhe Përkrenarja e Skënderbeut përmenden për herë të parë në vitin 1593 në inventarin e koleksionit Ambraser të Ferdinandit II. Arqiduka Ferdinand II i Tirolit (1529-1595) ishte një koleksionist i apasionuar i armatimeve. Për Ferdinandin II Skënderbeu ishte mjaft i rëndësishëm, sepse pas fushbetejës së tij të suksesshme të vitit 1556 kundër turqve në Hungari ai e shihte veten si një pasardhës të drejtëpërdrejtë të Skënderbeut. Që prej viteve 1580 Armët e Skënderbeut nuk janë larguar asnjëherë nga territori austriak.

**Rreth SIGAL UNIQA Group Austria**

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, u shpall sërish ketë vit si një ndër 100 kompanitë më të mëdha të Europës Jug-Lindore pasi përbëhet nga 7 kompani sigurimi dhe 1 fond pensionesh private, numëron rreth 400,000 klientë dhe ofron 45 produkte sigurimi.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në publicrelations@sigal.com.al

UNIQA > Njoftime per shtyp > SIGAL-UNIQA një histori suksesi

## SIGAL-UNIQA një histori suksesi

Mbushen 5 nga hyrja e investitorit strategjik në fushën e sigurimeve UNIQA Insurance Group hyri 5 vjet më parë në tregun shqiptar të sigurimeve përmes blerjes së aksioneve të kompanisë më të madhe të sigurimeve në vend SIGAL sh.a. Marrëveshja fillestare u firmos në 23 Mars 2007 për blerjen e 45.64% të aksioneve dhe më pas u përforcua dy vjet më vonë (Nëntor 2009) më blerjen e 23% aksione të tjera. Aktualisht, UNIQA Group AUSTRIA është aksioneri më i madh i SIGAL pasi zotëron 68.64% të aksioneve të kompanisë.

Investimi në SIGAL është konsideruar një histori suksesi nga UNIQA Insurance Group e cila operon në 21 shtete evropiane. Rritja që ka pasur SIGAL në të tre tregjet ku operon (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni) ka qënë vazhdimisht mbi rritjen mesatare të tregut ndërkohë që SIGAL është e vetmja kompani brenda grupit UNIQA që udhëheq tregun e sigurimeve.

Nga ana tjetër, partneriteti me UNIQA, i ka mundësuar SIGAL por edhe të gjithë tregut shqiptar të sigurimeve mbështetjen financiare dhe atë manaxheriale përmes eksperiencës 130 vjecare të UNIQA, sjelljes së praktikave të mira dhe shkëmbimit të përvojave ndërmjet kompanive anëtare të UNIQA të cilat operojnë në shtete që kanë një histori shumë të gjatë të sigurimeve. Me mbështetjen e UNIQA, SIGAL ka sjellë produkte novatore sigurimi të tilla si sigurimet e shëndetit dhe ato të jetës me kursim.

**Rreth UNIQA Insurance Group**

UNIQA Insurance Group është grupi më i madh Evropian i sigurimeve në Evropën Qendrore.

Grupi ka një prezencë të fortë rajonale pasi operon në 21 vende të Evropës dhe që nga viti 2007 ka shtrirë aktivitetin e saj edhe në Shqipëri nëpërmjet shoqërisë së sigurimeve SIGAL UNIQA Insurance Group.

Viti 2011 ishte një vit i suksesshëm për UNIQA Insurance Group pasi gjatë tij u arrit një vlerë prej 6 Miliardë Euro prime të shkruara dhe një rritje prej 4.4% në volum primesh.

UNIQA Insurance Group bazon strategjinë e saj tek rritja e qëndrueshme, zgjerimi dhe ndërkombëtarizimi duke vënë theksin veçanërisht tek përforcimi i pozitave të Grupit në tregjet në zhvillim. Ndër të tjera, suksesi në rritje i UNIQA Insurance Group është atribut i njohjes shumë të mirë të tregjeve ku operon, bashkëpunimit me partnerë të fuqishëm lokalë, risisë së produkteve dhe shërbimi ndaj klientit.

**Rreth SIGAL UNIQA Insurance Group**

SIGAL sh.a u themelua në 22 Shkurt 1999 si Kompania e parë private e sigurimit në Shqipëri dhe ka degët e saj në Kosovë dhe Maqedoni. Aktualisht, SIGAL UNIQA Insurance Group është grupi më i madh

i sigurimeve në vend dhe më gjerë pasi përbëhet nga 7 kompani sigurimi dhe 1 fond pensionesh: SIGAL UNIQA Insurance Group (Jo-Jetë, Shqipëri), SIGAL Life UNIQA Insurance Group (Jetë, Shqipëri), SIGAL UNIQA Insurance Group Risigurime, SIGAL UNIQA Insurance Group Kosova (Jo-Jetë, Kosovë), SIGAL Life UNIQA Insurance Group Kosova (Jetë, Kosovë), UNIQA a.d (Jo-Jetë, Maqedoni), UNIQA Life a.d (Jetë, Maqedoni) dhe Fondi i Pensioneve Private SIGAL Life UNIQA Insurance Group.

Që prej vitit 2002, SIGAL është udhëheqës i tregut duke zotëruar mesatarisht 30% të tregut të sigurimeve jetë, jo-jetë dhe pensioneve private në vend. SIGAL UNIQA është gjithashtu udhëheqës i tregut edhe përsa i përket pagesës së dëmeve.

Gjatë vitit 2011 tregu shqiptar i sigurimeve ( jetë dhe jo-jetë) u rrit me 1.81% ndërkohë që dy kompanitë SIGAL që ushtrojnë aktivitetin në këtë treg ( SIGAL Jo-Jetë dhe SIGAL Life) u rritën me 7.78% ( në volum primesh). Të klasifikuara sipas produkteve, sigurimet e shëndetit dhe Kartonit Jeshil patën rritjen më të madhe, pasuar nga sigurimet e pasurisë, sigurimet motorike dhe ato të marinës dhe aviacionit.

Për më shumë informacion, ju lutem na kontaktoni në publicrelations@sigal.com.al

## Inaugurohet Teatri SKAMPA: u rindërtua falë pagesës së dëmit nga SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Data 22 Shkurt 2012 shënon inaugurimin e një prej teatrove më të rëndësishëm në Shqipëri, teatrit Skampa i cili u shkatërrua plotësisht 6 muaj më parë si pasojë e një zjarri në një godinë pranë tij dhe u rindërtua falë SIGAL UNIQA dhe Bashkisë Elbasan.

Në ceremoninë e inaugurimit morën pjesë Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, përfaqësues të lartë të pushtetit vendor në Elbasan dhe artistë. Ceremonia e inaugurimit përfshiu gjithashtu një mbrëmjeje artistike gjatë së cilës do të performojnë artistë të njohur shqiptarë si dhe trupat artistike të qytetit të Elbasanit.

**Djegia dhe rindërtimi**

Që nga viti 2009, SKAMPA dhe shumë objekte të tjera të qytetit të Elbasanit, nën kujdesin e Bashkisë Elbasan jane siguruar pranë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA.

Më 4 Gusht 2011, Teatri Skampa u përfshi nga flakët si pasojë e të cilave u dëmtuan plotësisht skena, platea, lozhat dhe dhomat e artistëve dhe dëmet e llogaritura kapën vlerën e qindra mijëra euro. SIGAL pas kësaj humbjeje financiare vendosi t'i kthejë vlerën artistike dhe historike qytetit. Rikonstruksioni filloi brenda pak ditësh për të përfunduar në një kohë rekord prej 6 muajsh dhe u bë i mundur nga dëmshpërblimi i vlerës së dëmit të paguar nga kompania e sigurimeve SIGAL UNIQA dhe kontributi i Bashkisë Elbasan. Falë këtij investimi, SKAMPA është sot teatri më modern në Shqipëri, me kushte optimale dhe akustikë edhe më të mirë.

**Nevoja për sigurim**

Teatri SKAMPA është siguruar tek SIGAL UNIQA ashtu sikurse edhe shumë prona dhe pasuri shtetërore e private në qytetin e Elbasanit, në Shqipëri e në rajon.

